



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.118

17 nëntor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9617
datë 16.10.2006

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës””..

4717

Ligj nr.9618
datë 16.10.2006

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Haci Sakir Sabun ve Gliserine Fabrikalari Turk Anonim Sirketi” Stamboll, Turqi për riskedulimin
borxhit”.....

e 4726

Ligj nr.9619
datë 16.10.2006

Për ratifikimin e “Protokollit për pranimin e Komunitetit European në Konventën Ndërkombëtare të Eurokontrollit, për bashkëpunimin për sigurinë e navigimit ajror, të 13 dhjetorit 1960, të ndryshuar me anë të amendimit dhe të konsoliduar nga Protokollit i 27 qershorit 1997”.....

4727

Ligj nr.9620
datë 16.10.2006

Për ratifikimin e “Marrëveshjes shumëpalëshe “Për ngritjen e një rrjeti hekurudhor, të performancës së lartë, në Europën Juglindore””.....

4731

Ligj nr.9621
datë 16.10.2006

Për miratimin e Buxhetit faktik të Shtetit të vitit 2005.....

4736

Ligj nr.9622
datë 16.10.2006

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ushtarake grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”.....

4737

Ligj nr.9623 datë 16.10.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër dopingut në sport, 2005.....	4738
Ligj nr.9624 datë 16.10.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shumëpalësh të Konventës “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave (CMR)”	4756
Ligj nr.9625 datë 16.10.2006	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”	4760
Ligj nr.9626 datë 16.10.2006	Për disa shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar	4761

LIGJ
Nr.9617, datë 16.10.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME, PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT “FUQIZIMI I QENDRËS TRAUMATOLOGJIKE KOMBËTARE TË TIRANËS””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5091, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Në vijim të quajtura “Palët Kontraktuese” për realizimin e programit “Fuqizim i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”

Duke pasur parasysh:

se në protokollin e bashkëpunimit për trevjeçarin 2002-2004, Qeveria Italiane ka marrë përsipër të financojë një ndërhyrje për fuqizimin e Qendrës Traumatologjike Kombëtare dhe për të përmirësuar funksionalitetin e saj, duke përcaktuar për këtë qëllim një kredi ndihmëse prej 5 000 000,00 euro dhe një donacion prej 150 000,00 euro;

se në mbledhjen e datës 16 maj 2005 Komiteti Drejtues i Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) është shprehur pro dhënies së një kredie ndihmëse prej 5 000 000,00 dhe vendosi dhënien e një donacioni prej 150 000,00 euro për realizimin e ndërhyrjes “Fuqizim i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”, në vijim i quajtur Programi, parashtruar gjithë sa më sipër,

Palët Kontraktuese ranë dakord për sa vijon:

Neni 1

Qëllimi dhe Palët e Marrëveshjes

a) Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë angazhimet e ndërsjellta të dyja Palëve për zbatimin e saktë të Programit, duke iu referuar në veçanti modaliteteve të dhënies së kontratave, si dhe atyre të menaxhimit/llogaritjes/livritimit të fondeve të kredisë ndihmëse.

b) Kjo Marrëveshje përbëhet nga 15 nene dhe nga 3 anekse, siç janë treguar në vijim, të cilat janë pjesë përbërëse të saj:

1. përmbledhje e Programit;
2. prokurimi i shërbimeve, furnizimeve e punimeve (kushtet e veçanta);
3. modalitetet e zbatimit dhe të administrimit të kredisë së ndihmës.

Neni 2

Objektivat e Programit

a) Objektivi i përgjithshëm i Programit është i vetëm dhe qëndron në përmirësimin e gjendjes së shëndetit të popullsisë shqiptare, në mënyrë të veçantë të popullsisë së prekur nga trauma.

b) Objektivat specifike kërkojnë të bëjnë më eficientë e më efikasë veprimtarinë terapeutike të Qendrës Traumatologjike Kombëtare, duke rritur në këtë mënyrë ndikimin mbi shëndetin e popullsisë dhe njëkohësisht për të përmirësuar prognozën *quod valitudinem* të pacientëve politraumatikë me pasojë uljen e paaftësive të përkohshme dhe të përhershme dhe të kostove që lidhen me to.

Neni 3

Përshkrimi i Programit

a) Programi është përcaktuar shkurtimisht në aneksin 1 dhe synon të arrijë pajisjen e Qendrës Traumatologjike Kombëtare me aparaturat e duhura mjekësore dhe ta bëjë atë të përshtatshme për rolin që ajo ka si pikë referimi kombëtare për pacientët e traumatizuar.

b) Zbatimi i Programit shpie në furnizimin me:

- pajisje mjekësore dhe orendi;
- një shërbim asistence teknike, mirëmbajtje dhe trajnime të specializuar;
- përpos garancisë së zakonshme të pajisjeve;
- një sasi të përshtatshme materialesh konsumi për QTK.

Neni 4

Institucione të përfshira në realizimin e Programit

Institucionet e përfshira në realizimin e Programit janë si vijon:

a) Për Palën Italiane:

1. MPJ/DPKZH (Ministria e Punëve të Jashtme/Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim për Zhvillim) që do të sigurojnë livrimin e burimeve financiare me kredi, sipas mënyrave të parashikuara nga kuadri ligjor italian në fuqi, e që përmbledhtazi tregohen në këtë Marrëveshje. MPJ/DPKZH, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes (MM) Shqiptare, do të kenë gjithashtu përdorim të detyrë të kontrollojnë ecurinë e Programit dhe aftësinë e tij për të arritur rezultatet e treguara në nenin 3 të mësipërm. MPJ/DPKZH do të veprojnë përmes zyrtarëve kompetentë për kryerjen e detyrave të veta. Në veçani, Zyra Teknike Qendrore e MPJ/DPKZH, në vijim e quajtur ZTQ, do të garantojë të gjitha funksionet me karakter teknik në mbështetje të realizimit të Programit.

2. Artigiancassa që - sipas udhëzimeve të MPJ/DPKZH dhe të Ministrisë së Ekonomisë Italiane – do të lidhë me Ministrinë e Financave Shqiptare (MF) një marrëveshje financiare që do të rregullojë përdorimin e fondeve të kredisë ndihmëse. Në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje financiare, Artigiancassa do të kujdeset për lidhjen e kontratave të veçanta për livrimin e të mirave, shërbimeve dhe punimeve, përmes të cilave do të realizohen veprimtaritë e parashikuara në Program. Do të kujdeset gjithashtu për të siguruar pagesën e shumave të kontratave në favor të organizmave realizues.

3. Ambasada/ZTL (Zyra Teknike Lokale) në Tiranë, e cila do të garantojë të gjitha funksionet me karakter teknik të nevojshme për të siguruar ecurinë e rregullt të punimeve. Në kuadrin e funksioneve të veta institucionale, Ambasada/ZTL do të sigurojë gjithashtu kontaktet e nevojshme me kundërpalët e Programit, duke u kujdesur, ndër të tjera, për marrjen dhe përcjelljen e gjithë dokumentacionit zyrtar.

b) Për Palën Shqiptare:

1. MM, e cila do të sigurojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë strukturat e tjera kompetente shqiptare (në veçanti Ministrinë e Shëndetësisë) dhe do të kujdeset të bashkërendojë funksionet me karakter teknik dhe drejtues të nevojshme për realizimin e Programit.

2. MF, e cila do të lidhë Marrëveshjen financiare me Artigiancassa dhe do të kujdeset për kontaktet operative me këtë të fundit, sipas sa përcaktuar në Marrëveshjen financiare.

Neni 5

Burimet financiare dhe modalitetet e përdorimit të kredisë së ndihmës

a) Burimet financiare të nevojshme për realizimin e Programit janë si vijon:

1. Kredia ndihmëse prej 5 000 000 euro për realizimin e të gjitha veprimtarive të parashikuara në Program.

2. Donacion prej 150 000 euro për veprimtaritë e kontrollit dhe asistencës teknike si gjatë shpalljes së tenderave, ashtu dhe gjatë zbatimit të veprimtarive të Programit.

b) Afatet dhe kushtet e kredisë ndihmëse janë si vijon:

- periudha e kthimit të kredisë: 19 vjet
- periudha e faljes (për kthimin e kredisë): 8 vjet
- përqindja e interesit vjetor: 0.20%.

c) Në bazë të procedurave në fuqi pranë MPJ/DPKZH, fazat kryesore, që duhen ndjekur për përdorimin e fondeve të kredisë ndihmëse, janë si më poshtë (më mirë specifikuar në aneksin 3):

1. nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje;

2. nxjerrja nga ana e Ministrisë së Ekonomisë Italiane e një urdhri ministror, që autorizon Artigiancassa të negociojë dhe nënshkruajë Marrëveshjen financiare me Ministrinë e Financave;

3. lidhja e Marrëveshjes financiare mes Artigiancassa dhe MF;

4. përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i tenderit, për të përcaktuar ata që do të ofrojnë furnizimet, shërbimin e asistencës, mirëmbajtjes dhe trajnimit me shpalljen e tenderit në Itali (në ngarkim të MPJ/DPKZH) dhe në Shqipëri (në ngarkim të MM);

5. vlerësimi i ofertave nga ana e komisionit të ngritur nga MM dhe shpallja, me klauzolë pezulluese, e fituesit të tenderit;

6. verifikim, nga ana e MPJ/DPKZH, i përputhshmërisë së procedurës së ndjekur për përzgjedhjen dhe kontratat që do të lidhen, dhe në rast përfundimi pozitiv, kjo e fundit do të japë *no objection* (miratohet pasi nuk ka kundërshtime) për lidhjen e kontratës së furnizimit nga ana e MM;

7. lidhja dhe llogaritja e kontratave mbi bazën e Marrëveshjes financiare, me modalitetet e livrimit të fondeve të treguara në aneksin 3.

Neni 6

Monitorimi i Programit – komiteti drejtues

a) Programi do të monitorohet përmes një komiteti drejtues, i përbërë nga dy anëtarë të caktuar, njëri nga MPJ/DPKZH dhe tjetri nga MM.

b) Komiteti do të ketë për detyrë të monitorojë veprimtaritë, e në veçanti:

- marrëdhëniet mes institucioneve të përfshira në Program;
- shqyrtimin e dokumentacionit të tenderit përgatitur nga përfituesi i tij dhe të asistojë, nëse do të jetë e nevojshme, përgatitjen e tenderit në lidhje me procedurat e prokurimit;
- të ndihmojë grupin e ekspertëve shqiptarë të përcaktuar nga MM;
- të monitorojë dhe vlerësojë realizimin e Programit.

c) Gjatë mbledhjeve të komitetit drejtues duhet të merren parasysh propozimet dhe masat e përbashkëta për fazat e mëtejshme të realizimit.

d) Duhet të merret mendimi i komitetit për çdo vendim në lidhje me Programin, e ky i fundit mund të merret vetëm me pëlqimin e vetë komitetit.

e) Në përfundim të Programit do të thirret një mbledhje për të bërë një analizë përfundimtare të kontrollit të veprimtarive të Programit.

Neni 7

Mënyrat e përfitimit të shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve

a) Përcaktimi i zbatuesve të veprimtarive të Programit do të kryhet përmes kryerjes së tenderave të rregulluar nga dispozita që përmban Manuali i Procedurave (përfutur nga Komisioni Europian më 23 dhjetor 2002), në lidhje me “Prokurime shërbimesh, furnizimesh dhe punimesh në kuadrin e bashkëpunimit të Komunitetit Europian me vendet e treta”, si dhe nga sa saktësuar në aneksin 2.

Neni 8

Detyrime të Qeverisë Italiane

a) Qeveria Italiane merr përsipër të sigurojë financimin:

- deri në 5 000 000, 00 euro si kredi ndihme, që do të jetë e disponueshme pranë Artigiancassa dhe do të livrohet sipas sa saktësuar në aneksin 3;

- deri në 150 000,00 euro, si donacion, që do të administrohet drejtpërsëdrejti nga MPJ/DPKZH për kontraktimin e ekspertëve dhe konsulentëve për veprimtarinë e kontrollit dhe menaxhimit të kredisë.

Neni 9

Detyrime të Qeverisë Shqiptare

- a) Qeveria Shqiptare merr përsipër:
- të vërë në dispozicion burimet financiare në kompetencë të saj, të barabarta me rreth 1 000 000, 00 euro të barasvlefshme;
 - t'i bëjë operative të gjitha veprimet, veprimtaritë dhe aktet zyrtare të domosdoshme për përfundimin me sukses të Programit;
 - të bashkëpunojë me MPJ/DPKZH për veprimtaritë e monitorimit të Programit, sipas nenit 6, edhe që kjo e fundit të mund të ketë akses ndaj dokumentacionit ekzistues dhe në hapësirat ku ai vepron.

Neni 10

Klauzola antikorrupsion

a) Qeveria Italiane është angazhuar në luftën kundër korrupsionit në të gjitha format e shfaqjes së tij. Në veçanti, me qëllim që të shmangët çdo rast veprimtarie e paligjshme dhe parregullsie gjatë paraqitjes së ofertave për furnizimet, shërbimet dhe punimet civile, Qeveria Italiane ka parashikuar për të gjithë pjesëmarrësit në tender detyrimin për të nënshkruar dhe paraqitur një *Integrity Pact*, së bashku me ofertat e tyre apo me kontratat e miratuara. Mosparaqitja e *Integrity Pact* do të shpjerë në përjashtimin e menjëhershëm nga tenderi dhe mosrespektimi i kësaj gjëje gjatë zbatimit të kontratës së miratuar do të përbëjë arsye për të zbatuar sanksionet e ndjeshme të parashikuara në të. Parashikimi i kësaj klauzole synon të sigurojë një konkurrencë të rregullt dhe mundësi të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit në tender, si dhe një zbatim të saktë e transparent të kontratës së miratuar.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Çdo mosmarrëveshje që do të lindë mes Palëve Kontraktuese në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet, përsa të jetë e mundur, me anë të këshillimit dhe negociatave.

Neni 12

Pengesa dhe forca madhore

a) Në rast pengese për realizimin e Programit, për shkaqe të forcës madhore (luftë, përmytje, zjarr, tufan, tërmet, konflikte në punë, greva, masa e urdhra të marrë nga qeveritë përkatëse, vështirësi të paparashikuara në transport e shkaqe të tjera) të njohura nga të dyja Palët, apo në rast rreziku apo kushtesh të rrezikshme për personelin e ardhur nga jashtë vendit, do të gjejnë zbatim dispozitat e mëposhtme, mbështetur në rekomandimet e kryesisë së Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe të miratuara nga MPJ/DPKZH:

1. Nëse kohëzgjatja e pengesës për realizimin e Programit është më e vogël se gjashtë muaj, përdorimi i fondeve të papërdorura deri atëherë pezullohet deri kur MPJ/DPKZH do të autorizojë rifillimin e veprimtarive.

2. Nëse kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se gjashtë muaj dhe më e vogël se njëzet e katër, Programi pezullohet dhe fondet e papërdorura mbahen, deri sa pengesa të mos ekzistojë më dhe të mbërrijë autorizimi i MPJ/DPKZH për rifillimin e veprimtarive.

3. Nëse kohëzgjatja e pengesës do të jetë më e madhe se njëzet e katër muaj, Palët janë të detyruara të merren vesh mbi vazhdimësinë e Programit dhe të përcaktojnë radhën e veprimeve. Në rast se vazhdimësia e veprimtarive do të jetë e pamundur, Palët duhet të vendosin mbi përdorimin e fondeve të papërdorura.

Neni 13

E drejta e MPJ/DPKZH për zgjidhjen e Marrëveshjes

a) MPJ/DPKZH ruan të drejtën për të hequr dorë nga Marrëveshja në këto raste:

1. Mosrealizim i veprimtarive të parashikuara nga Programi, për shkaqe që nuk kanë të bëjnë me Palën Italiane.

2. Pengesë e zgjatur në kohë apo forcë madhore në bazë të nenit paraardhës 12.

b) Në dy rastet e përmendura më lart, MPJ/DPKZH mund të vendosë në mënyrë të njëanshme përfundimin e Marrëveshjes, duke ia njoftuar atë MM-së dhe MF-së përmes një note verbale të paktën tre muaj më parë. Sidoqoftë, pas një njoftimi të tillë, MM-ja është e detyruar të ndërpresë veprimtaritë e Programit, me përjashtim të rastit kur Palët kanë rënë dakord ndryshe.

Neni 14

Ndryshimi

a) Palët mundën në çdo kohë të propozojnë ndryshime në përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje përmes rrugëve diplomatike. Amendamentet a ndryshimet e mundshme, për të cilat Palët bien dakord, do të hyjnë në fuqi sipas procedurave të parashikuara sipas nevojës.

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe denoncimi

a) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë, ndër dy njoftimet e kryera, me të cilin Palët Kontraktuese do të kenë njoftuar zyrtarisht kryerjen e procedurave përkatëse të brendshme, të parashikuara sipas nevojës.

b) Kjo Marrëveshje do të ketë një kohëzgjatje trevjeçare dhe do të ripërtërihet heshturazi për periudha të mëtejshme me të njëjtën kohëzgjatje.

c) Kjo Marrëveshje mund të denoncohet në çdo kohë dhe denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas njoftimit të saj te Pala tjetër Kontraktuese.

Në besim të sa më sipër, të nënshkruarit përfaqësues, rregullisht të autorizuar nga qeveritë përkatëse, nënshkruan këtë Marrëveshje.

U shkrua në Tiranë më 2006, në dy kopje origjinale, çdonjëra në gjuhën italiane dhe shqipe. Në rast mospërputhjeje interpretimi, do të kryesojë teksti në gjuhën italiane.

ANEKSI 1**PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT****1. Përshkrimi**

Programi parashikon pajisjen e plotë të Qendrës Traumatologjike Kombëtare me pajisjet e duhura mjekësore dhe orënditë, me qëllim që ta bëjë më eficientë e më efikase veprimtarinë e saj terapeutike për shëndetin e popullsisë, pra të përmirësojë prognozën *quoad valitudinem* e pacientëve politraumatikë, që do të shpjerë në uljen e paaftësive të përkohshme dhe të përhershme dhe të kostove përkatëse që shoqërojnë këto të fundit. Furnizimi me aparaturë mjekësore dhe orëndi u bashkohet shërbimi i asistencës dhe mirëmbajtjes, i shoqëruar nga një plan trajnimi klinik të specializuar dhe një sasi e caktuar materialesh konsumi për *start up* (vënien në punë) të aparaturave.

Shuma e përgjithshme e kredisë prej 5 milionë euro përfshin në vetvete furnizimin me:

- aparaturë biomjekësore dhe orëndi (4.6 milionë euro);
- asistencë, mirëmbajtje dhe trajnim (0.22 milionë euro);
- materiale konsumi (0.18 milionë euro).

Pjesa e donacionit, që do të administrohet drejtpërsëdrejti nga DPKZH, siç sqaruar më mirë në vijim, ka për qëllim veprimtarinë e asistencës teknike dhe të kontrollit në ministrinë përfituese (0.15 milionë euro).

Furnizimi me aparaturat mjekësore bazohet në rilevimet e zhvilluara gjatë fazës së hartimit dhe në “Master Plan of Emergency Department and dhe Operation Unit of National Trauma Center”.

Programi përbëhet nga tri elemente (elementi i kredisë):

A. Furnizimi i aparaturave biomjekësore dhe orëndive

Kooperacioni italian financon, me kredi ndihmëse, aparaturat biomjekësore dhe orënditë e nevojshme për ndihmën e shpejtë, bllokun operator, reanimacionin, shtrimet sipas specialiteteve të ndryshme kirurgjikale dhe morgun.

Furnizimi do të përfshijë edhe një shërbim diagnostikimi me imazh që do të përbëhet nga një njësi radiologjie dhe një njësi për rezonancën magnetike. Duke pasur parasysh specifikën e shërbimit të ofruar nga Qendra Traumatologjike Kombëtare, vendosja e shërbimit të rezonancës magnetike në këtë Qendër konsiderohet shumë e rëndësishme për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit terapeutik të Qendrës, si dhe për rritjen e treguesit të mbulimit në nivel kombëtar të këtij shërbimi diagnostikues.

Kujdes i veçantë duhet treguar ndaj homogjenitetit të teknologjisë, cilësisë dhe thjeshtësisë në përdorimin e mirëmbajtjen e aparaturave.

Njësitë që do të pajisen me financimin italian do të jenë:

a.1. Ndihma e shpejtë:

Përsa i përket ndihmës së shpejtë, furnizimi do të konsistojë në pajisjen e një mjedisi për pranimin dhe ndjekjen e pacientëve, dy salla operacioni për pranimin dhe ndjekjen e pacientëve, dy salla operacioni për trajtimin e pacientëve politraumatikë (sallat trauma), një sallë operacioni për ndërhyrje të kirurgjisë së përgjithshme, një laborator për analiza klinike të urgjencës, një sistem informacioni për menaxhimin e pranimeve dhe të gjitha mjedisve të shërbimit shtesë për funksionimin e rregullt të shërbimit të urgjencës.

a.2. Blloku operator:

Blloku operator do të përbëhet nga pesë salla operacioni të pajisura sipas tipologjive të ndryshme të ndërhyrjeve kirurgjikale dhe me mjediset e nevojshme për funksionimin e rregullt të tij si: filtra, hapësira për përgatitjen e pacientëve, sterilizimin, nënsterilizimin dhe mjedisë shërbimi për stafin e sallës së operacionit. Sallat e operacionit që parashikohen të pajisen janë: një sallë për ndërhyrjet ortopedike, një sallë për ndërhyrjet neurokirurgjike dhe tri salla për ndërhyrjet në urologji, gastroenterologji, kirurgji vaskulare, gjinekologji, otorinolaringoiatri dhe okulistikë.

a.3. Terapi intensive (reanimacion):

Reanimacioni (terapia intensive) do të organizohet në tre sektorë kryesorë: zona e terapisë intensive (8 shtretër, 1 prej të cilëve për pacientë të infektuar dhe 2 për pacientë me djegie), zona e terapisë subintensive (8 shtretër), dhoma e kontrollit.

a.4 Diagnostikimi me imazh:

Diagnostikimi me imazh do të përbëhet nga një njësi radiologjike dhe një rezonancë magnetike. Shërbimi i radiologjisë do të përbëhet nga një aparaturë radiologjike fikse dhe nga një sistem për fluoroskopinë. Ky shërbim do të pajiset me të gjithë aksesoret dhe mjediset e nevojshme për funksionimin e tij.

Rezonanca magnetike që mendohet të ofrohet do të jetë e llojit me “magnet fiks” për aplikime ortopedike dhe traumatologjike. Ky furnizim duhet të përfshijë të gjitha hollësitë e nevojshme për funksionimin e rregullt të implantit.

a.5 Shtrimet:

Shtrimet do të pajisen me gjithë sa është e domosdoshme. Parashikohet të furnizohen shtretërit për shtrimet dhe orenditë më të nevojshme përkatëse për të gjithë 120 shtretërit në repartet e ndryshme.

a.6 Salla e morgut:

Morgu do të parashikojë pajisjen e sallës për ruajtjen e kufomave, sallën për autopsinë dhe pajisjen e mjedisëve ndihmës, si ato të përgatitjes së mjekëve dhe sterilizimit.

Është parashikuar një zë shpenzimi (a.7 Energji elektrike e vazhdueshme) për blerjen e aparaturave që janë në gjendje të sigurojnë vazhdimësinë e shërbimit të energjisë elektrike, sidomos për njësitë operative, funksionimi i të cilave është kritik për shëndetin e pacientit ose ruajtjen e aparaturave. Parashikohet për këtë arsye furnizimi i grupeve statike të rrymës së vazhdueshme (UPS), vendosja dhe përdorimi i të cilave do të përcaktohen gjatë hartimit të planit të përgjithshëm për pajisjet. Në mbështetje të këtyre grupeve do të shihet mundësia për të përfshirë furnizimin e një gjeneratori. Parashikohet, gjithashtu që ky zë të përdoret për një përshtatje të mundshme të rrjetit elektrik sipas normativës europiane.

B. Furnizimi i një plani për asistencë dhe mirëmbajtje

Për të siguruar funksionimin e plotë të aparaturave biomjekësore, Programi duhet të ofrojë furnizimin me aparatura, përveç trajnimit specifik, por edhe një plan asistence e mirëmbajtje për një shërbim të plotë e të përgjithshëm, që bën të mundur përballimin e nevojave që mund të lindin në fazën e parë të vënies në punë të aparaturave biomjekësore. Ky plan asistence dhe mirëmbajtjeje do të konsistojë në ndërhyrje si për ndreqjen, ashtu dhe për parandalimin e problemeve. Ky plan asistence përfaqëson një element thelbësor për qëndrueshmërinë e ndërhyrjes pasi, nëse do të menaxhohej ashtu siç duhet dhe do të shoqërohej nga personel teknik lokal, do të ishte një mundësi e mirë për transferimin e njohurive.

Kohëzgjatja e këtij plani asistence dhe mirëmbajtjeje duhet të jetë njëvjeçar. Mendohet se kjo është kohëzgjatja e përshtatshme për të nisur këtë transferim të nevojshëm të kompetencave.

C. Furnizim i materialeve të konsumit

Furnizimi i të mirave parashikon një sasi të përshtatshme materialeve konsumi për aparaturat kryesore që shërbejnë për të kapërcyer fazën kritike të vënies në punë të njësive që do të pajisen.

2. Kohëzgjatja e ndërhyrjes

Ndërhyrja e financuar me kredi ndihme do të ketë një kohëzgjatje të përgjithshme prej 24 muajsh.

Gjatë periudhës së parë gjashtëmujore, duhet të kryhet puna përgatitore për tenderin, që duhet financuar nëpërmjet donacionit.

3. Plani i shpenzimeve dhe livrimeve

Burimet e financimit italian do të mund të përdoren vetëm për veprimtaritë e parashikuara nga kjo Marrëveshje. Rialokimet dhe rregullimet mes zërave të veçantë të parashikuar për furnizimet, asistencën, mirëmbajtjen dhe trajnimin, si dhe për materialet e konsumit, siç parashikohet në tabelën 1, në rritje apo në ulje, brenda një shume maksimale prej 20% dhe sidoqoftë pa ndryshuar shumën e përgjithshme, mund të vihen nga enti zbatues. Ndryshime më të mëdha se 20% duhet t'i nënshtrohen miratimit të Qeverisë Italiane.

4. Në ngarkim të palës shqiptare do të jenë:

a) përjashtimet nga taksat e tatimet;

b) shpenzime më të mëdha të mundshme për të papritura dhe rishikim të çmimeve.

Në asnjë rast fondet e financimit italian nuk mund të përdoren për të paguar tatimet vendore dhe ato doganore ose TVSH-në. Furnizimet dhe shërbimet e importuara në lidhje me realizimin e projektit do të përjashtohen nga çdo tatim apo taksë doganore shqiptare.

5. Raporti përfundimtar (RP)

RP do të përgatitet nga Drejtoria e Spitalit Ushtarak të Tiranës në fund të projektit e pasi të ketë marrë më parë miratimin e MM, ai i dërgohet MPJ/DPKZH. RP do të ketë këtë strukturë të përgjithshme: i) përmbledhje e përmbajtjes së projektit; ii) përshkrim i modaliteteve të zbatimit të projektit (tenderat, kalendar, shumat, realizime e ndryshime, kosto, financimi, performancë e ndërmarrjeve dhe enti zbatues); iii) performancë e projektit (operative, institucionale e financiare; iv) ndikimet (ekonomike, shoqërore, mjedisore etj.); v)

qëndrueshmëria e projektit; vi) performancë e DPKZH dhe Qeverisë; vii) performancë e përgjithshme; viii) përfundime e rekomandime.

6. Kostot e Programit (në ngarkim të kooperacionit italian)

Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur, vetëm për t'i treguar ato, kostot e llogaritura në zërat e ndryshëm.

Tab.1

KUADRI I PËRGJITHSHËM I KOSTOVE TË LLOGARITURA TË PROGRAMIT

Totali (€) Shuma (€)

A	Pajisje mjekësore dhe orendi	4 800 000	
A.1	Pajisja e ndihmës së shpejtë (urgjenca)		805 000
A.2	Pajisja e bllokut operator (sallat e operacionit)		1 430 000
A.3	Pajisja e repartit të reanimacionit (terapia intensive)		630 000
A.4	Pajisja e repartit të shtrimeve		360 000
A.5	Pajisja e shërbimeve të bioimazheve		1 205 000
A.6	Pajisja e morgut		50 000
A.7	Energji elektrike e vazhduar		80 000
B	Shërbimi i asistencës, mirëmbajtjes, trajnimit	220 000	
C	Materiale shërbimi dhe pjesë këmbimi	180 000	
	Kredia	5 000 000	
D	Misione të DPKZH	150 000	
D.1	Viti 2006		100 000
D.2	Viti 2007		50 000
	Donacioni (Fondi për ekspertë)	150 000	
	Totali i përgjithshëm i Programit	5 150 000	

ANEKSI 2

PROKURIM SHËRBIMESH, FURNIZIMESH DHE PUNIMESH
(KUSHTET E VEÇANTA)

Kjo Marrëveshje i referohet përdorimit të kredisë së ndihmës italiane.

Caktimi i kontratave do të kryhet përmes tenderave, ku mund të marrin pjesë vetëm shoqëritë italiane. Përqindja e kredisë së ndihmës që mund të përdoret për kostot lokale dhe/ose në vendet në zhvillim nuk mund të jetë më e lartë se 40% e vetë kredisë.

Për caktimin e gjithë kontraktimeve të parashikuara në Program, do të ndiqen procedurat e parashikuara në manualin e procedurave (përfituar nga Komisioni European i datës 23 dhjetor 2002) dhe ndryshime të mëtejshme të mundshme, në lidhje me: prokurim shërbimesh, furnizimesh dhe punimesh në kuadrin e bashkëpunimit të Komunitetit European me vende të treta.

Në çdo rast, procedura e përzgjedhjes duhet të përfshijë sidoqoftë:

- kontrollin e përshtatshmërisë së ofertuesve (persona juridikë, shoqëri dhe ndërmarrje), që nuk do të gjykojnë të përshtatshme nëse:

a) gjenden në kushte falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluar apo marrëveshje paraprake për shpalljen e gjendjes së falimentimit, ndërprerjeje të aktivitetit apo kur janë objekt i një procedure të ngjashme, parashikuar nga ligjet e rregulloret kombëtare;

b) janë objekt i një procedure për shpallje falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluar, marrëveshjeje paraprake për shpallje gjendje falimentimi apo i një procedure të ngjashme, siç është parashikuar nga ligjet e rregulloret kombëtare;

c) kanë marrë një dënim për një krim në lidhje me moralin profesional, për të cilin nuk mund të paraqitet ankim;

d) janë konsideruar përgjegjës për shkelje të rënda të detyrës profesionale, provuar me çdo element të dokumentueshëm nga administrata tenderuese;

e) nuk kanë shlyer rregullisht detyrimet e sigurimeve shoqërore sipas dispozitave ligjore të vendit ku janë vendosur;

f) nuk kanë shlyer rregullisht detyrimet në tatime e taksa sipas dispozitave ligjore të vendit ku janë vendosur;

g) janë shpallur fajtorë, për shkak të mosrespektimit të detyrimeve kontraktore, për mospërbushje të rëndë në lidhje me zbatimin e një tjetër kontrate të nënshkruar me po këtë administratë prokuruese ose në lidhje

me një kontratë tjetër të financuar me fonde të Komunitetit Europian.

Gjithashtu, ofertuesit italianë do të jenë të detyruar të paraqesin një certifikatë apo një deklaratë të barasvlefshme për mospërkatësi në kategoritë e treguara në dekretin legjislativ italian të datës 8 gusht 1994, nr.490 "Antimafia".

Për këtë arsye ofertuesit, në mbështetje të ofertave të tyre, duhet të paraqesin provat e zakonshme, në përputhje me legjislacionin e vendit në të cilin ato janë vendosur, të cilat provojnë që ata nuk ndodhen në asnjë prej rrethanave të parashikuara në pikat (a), (b), (c), (e) dhe (f).

- Kontroll i gjendjes ekonomike e financiare të ofertuesve, përmes:

a) deklarimit të kapitalit shoqëror të shoqërisë dhe të ardhurave në tre vjetët paraardhës të tenderit;

b) një deklaratë për të ardhurat totale të konkurruesve dhe, në rast asocimi të përkohshëm, të ardhurat e secilit prej pjesëmarrësve në këtë bashkim tregtar;

c) një deklaratë e cila dëshmon të ardhurat në sektorët specifikë të cilëve u referohet tenderi apo në sektorin ku, në rast asocimi të përkohshëm, shoqëria individuale mendon të kontribuojë;

d) një deklaratë të përshtatshme të përfaqësuesve ligjorë apo një dëshmi bankare, që përmban të dhëna mbi marrëdhëniet me institutet bankare me rëndësi në nivel ndërkombëtar që kërkojnë të dëshmojnë pranueshmërinë tregtare dhe financiare të konkurruesve dhe shoqërive që përbëjnë asocimin e përkohshëm;

e) një kopje e dëshmisë që vërteton se konkurruesi është anëtar i dhomës së tregtisë në vendin ku ndodhet;

f) në rast asocimi të përkohshëm, duhet të paraqitet një kopje e kontratës së asocimit të përkohshëm, ku tregohet shoqëria që do të jetë përgjegjëse para MPJ (MIE) për zbatimin e mundshëm të kontratës.

- Kontrolli i aftësisë teknike e profesionale të konkurruesve përmes:

a) një kopje të dokumenteve origjinale, që vërtetojnë përbërjen ligjore, statusin juridik dhe që përcaktojnë vendin e regjistrimit dhe/ose selinë kryesore ose zyrën e regjistrimit e, nëse këto nuk përkojnë, vendndodhjen e selisë kryesore të kompanisë, shoqërisë ose partnershipit të zakonshëm, apo të pjesëve të ndryshme që përbëjnë konkurruesit, në rast asocimi të përkohshëm;

b) një raport që përmban të dhëna të dokumentuara mbi përvojat e mëparshme të punës së konkurruesve apo të asocimit të përkohshëm në tendera që kanë pasur natyrë të ngjashme, në tre vjetët paraardhës, dhe në lidhje me prokurime të tjera në zhvillim e sipër, me të dhëna specifike mbi pjesëmarrjen konkrete dhe efektive në çdo tender;

c) cilësitë dhe përvojën e anëtarëve më të rëndësishëm të stafit, të cilët do të jenë të ngarkuar nga kontraktuesi për zbatimin e kontratës;

d) një raport të shkurtër mbi aktivitetin e konkurruesve, më vete apo të asociuar, duke iu referuar në mënyrë specifike veprimtarive në lidhje me Programin.

Pjesëmarrja i nënshtrohet paraqitjes së një vetëcertifikimi që vërteton kontrollin në vendet e ndërhyrjes.

Krahasimi i konkurruesve, në bazë të kriterëve të përcaktimit të fituesit, siç përcaktohet në njoftimin dhe në dosjen e tenderit, do të kryhet në bazë të kriterëve të përcaktuara më parë dhe të çmimit, për të përcaktuar konkurruesin që është më i leverdisshëm nga pikëpamja ekonomike.

Kriteret duhet të jenë të sakta, jo diskriminuese, e as nuk duhet të paragjykojnë konkurrimin e rregullt.

ANEKSI 3

MODALITETET E ZBATIMIT DHE MENAXHIMIT TË KREDISË SË NDIHMËS

SEKSIONI I

NXJERRJA E SHPALLJES SË TENDERIT DHE PROCEDURA ZBATUESE

Dokumentacioni duhet të përgatitet në përputhje me aneksin 2, që i referohet manualit të procedurave (përfutur nga Komisioni Europian, më datë 23 dhjetor 2002) dhe ndryshime të mëtejshme të mundshme, në lidhje me: prokurim shërbimesh, furnizimesh e punimesh në kuadrin e bashkëpunimit të Komunitetit Europian me vende të treta. Dokumentacioni, sidoqoftë, duhet:

- të specifikojë "kushtet e veçanta" në lidhje me secilin tender;

- të tregojë qartë kriteret e vlerësimit që do të përftohen nga komisioni i ngritur nga MM.

1. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit

MM do të përgatisë dokumentacionin e tenderit për përzgjedhjen e fituesve (punime dhe supervizion

punimesh) dhe do t'ia përcjellë/ambasadës/ZTL me kërkesën për të botuar shpalljen e tenderave në gazetën italiane.

2. Kontrolli i përputhshmërisë së dokumentacionit të tenderit

Kontrolli i përputhshmërisë me këtë Marrëveshje do të kryhet nga MPJ/DPKZH dhe do të mbështetet, veçanërisht, në përputhjen e:

-përmbajtjes me karakter ligjor me procedurat e treguara nga aneksi 2;

-technikave specifike dhe parametrave të vlerësimit me objektivat që Programi synon të arrijë.

3. Botimi i shpalljes së tenderit

Në rast përfundimi pozitiv të kontrollit, shpalljet e tenderave do të botohen nga ana e MPJ/DPKZH në gazetën e përditshme italiane, në buletin e kooperacionit dhe në faqet e internetit të MPJ. MM do të procedojë njëkohësisht me botimin e shpalljes së tenderave në gazetën e përditshme kombëtare.

SEKSIONI II

FAZA E CAKTIMIT TË FITUESIT- PROCEDURA ZBATUESE

1. Shqyrtimi i ofertave të paraqitura për çdo tender do të kryhet nga një komision vlerësimi i ngritur enkas nga MM. Në hapjen e ofertave do të marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit një përfaqësues i caktuar nga ambasada/ZTL.

2. Për çdo tender, MM do t'ia përcjellë ambasadës /ZTL dokumentacionin që përmban aktet e komisionit, së bashku me kontratën që duhet të lidhet, duke kërkuar të jepet miratimi për lidhjen e saj. Ky dokumentacion do të përcillet nga ambasada/ZTL pranë MPJ/DPKZH me komentet e rastit.

3. MPJ/DPKZH do të kontrollojë kryesisht përputhjen ligjore e teknike të vlerësimeve të kryera me procedurat e kriteret/parametrat e parashikuar në pjesën e posaçme të tenderit. Pasi të kenë përfunduar verifikimet, MPJ/DPKZH do të njoftojë ambasadën/ZTL për rezultatin e tyre.

4. Në rast se verifikimi do të ketë rezultat pozitiv (nuk ka asnjë pengesë), MM do të procedojë me lidhjen e kontratave me shoqëritë e shpallura fituese.

SEKSIONI III

FAZA E LIDHJES SË KONTRATAVE DHE LIVRIMEVE, PROCEDURA ZBATUESE

1. Kontratat e lidhura zyrtarisht me shoqëritë fituese dhe MM duhet të dërgohen në MPJ/DPKZH, së bashku me një kopje të *performance bond* dhe të sipërpërmendurit miratim (*nulla osta* – nuk ka asnjë pengesë) me një deklaratë angazhimi lëshuar nga pala shqiptare, për të përballuar kostot lokale (tatimi mbi vlerën e shituar, taksa doganore, shpronësime etj.).

2. Pasi të merret e shqyrtohet dokumentacioni, MPJ/DPKZH do të kujdeset të autorizojë Artigiancassa që kjo e fundit të lidhë kontratën në linjën e kredisë.

3. Sapo të ketë marrë miratimin e mësipërm, siç në pikën 2, Artigiancassa do të plotësojë praktikën përgatitore, në veçanti atë për eksportuesin italian. Më pas, kur praktika përgatitore të jetë përfunduar me sukses dhe të jetë marrë kërkesa për financim nga ana e kredimarrësit, Artigiancassa do t'ia njoftojë këtij të fundit, eksportuesit italian dhe MPJ/DPKZH hyrjen dhe financimin e kontratës në linjën e kredisë.

4. Artigiancassa do t'ia japë udhë livrimit të fondeve drejtpërsëdrejti te furnizuesit pasi të ketë marrë prej tyre kërkesën për livrim së bashku me dokumentacionin administrativ bashkëngjitur, siç parashikohet në kontratat e veçanta (fatura tregtare, *packing list*, *bill of lading* etj.) dhe pasi të ketë kontrolluar përputhshmërinë e vetë dokumentacionit me kontratën e autorizuar (një kopje e kërkesës për livrim do t'ia dërgohet kredimarrësit). Pagesat mund të urdhërohen vetëm pas miratimit për të proceduar nga ana e kredimarrësit; ky autorizim duhet të mbërrijë sidoqoftë brenda e jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së çdo kërkesë: përtej kësaj date, mospërgjigja nga ana e administratës do të konsiderohet si miratim i heshtur.

LIGJ

Nr.9618, datë 16.10.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “HACI SAKIR SABUN VE GLISERINE FABRIKALARI TURK ANONIM SIRKETI” STAMBOLL, TURQI PËR RISKEDULIMIN E BORXHIT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “Haci Sakir Sabun ve Gliserine Fabrikalari Turk Anonim Sirketi” Stamboll, Turqi për riskedulimin e borxhit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5092, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

PËR RISKEDULIMIN E BORXHIT

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE “HACI SAKIR SABUN VE GLISERINE FABRIKALARI TURK ANONIM SIRKETI” STAMBOLL,
TURQI**

Marrëveshje e datës2006 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Qeveria), i përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe “Haci Şakir Sabun ve Gliserin Fabrikalari Türk Anonim Şirketi”, Stamboll, Turqi, i përfaqësuar nga z. Ilyas Özşüer dhe z. Süleyman Aybars Erkan.

Neni 1

Objekt i kësaj Marrëveshjeje është riskedulimi i borxhit, për shumat e papaguara prej 711.450,00 USD, që rrjedh nga veprimet juridike tregtare të përfunduara gjatë vitit 1991 dhe që kanë mbetur të papaguara.

Përbërja e shumës së borxhit, e riskeduluar nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje riskedulimi është si më poshtë:

Kredi AG 7349/91, datë 21.1.1991, porosi nga Agroeksporti, shuma në USD 711.450,00.

Neni 2

Qeveria merr përsipër t’i paguajë “Haci Şakir Sabun ve Gliserin Fabrikalari Türk Anonim Şirketi”, Stamboll, Turqi shumën prej 711 450,00 USD, në shumë të plotë, menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Pagesa do të bëhet për poseduesin e llogarisë së “Haci Şakir Sabun ve Gliserin Fabrikalari Türk Anonim Şirketi”, në numrin e llogarisë 9099779 (llogari në USD), në Garanti Bank Kurumsal Şube Stamboll, Turqi (degë bankare e korporatës; numri i degës 381), me nr.IBAN përkatës: TR25 0006 2000 3810 0009 0997 79 USD.

Neni 3

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përfundimit të procedurave të nevojshme ligjore, që kërkohen nga legjislacioni shqiptar dhe mbetet në fuqi deri sa Palët të kenë përmbushur detyrimet e tyre të parashikuara në të.

Kjo Marrëveshje nuk ndryshohet pa pëlqimin me shkrim të të dyja Palëve.

Neni 4

Njoftimet e bëra në pajtim me këtë Marrëveshje shqyrtohen si më poshtë:

Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri.
Tel : ++3554228405,
Fax: ++3554228494

“Haci Şakir Sabun ve Gliserin Fabrikalari Türk Anonim Şirketi”, Stamboll, Turqi

Personi i kontaktit: Süleyman Aybars Erkan
Adresa: MAYA Holding INC.
Ebulula Cd
Maya Akatlar Sitesi, M-Blok
80630, Akatlar
Istanbul – Turkey
E-mail: aybars.erkana@maya.com.tr or aybars@tnn.net.tr
Tel: +90 212 351 00 22
Fax: +90 212 351 00 25 & + 90 212 351 00 31
Bërë në Tiranë, më.....2006, në tri kopje origjinale në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr.9619, datë 16.10.2006

PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT PËR PRANIMIN E KOMUNITETIT EUROPIAN NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE TË EUROKONTROLLIT, PËR BASHKËPUNIMIN PËR SIGURINË E NAVIGIMIT AJROR, TË 13 DHJETORIT 1960, TË NDRYSHUAR ME ANË TË AMENDIMIT DHE TË KONSOLIDUAR NGA PROTOKOLLI I 27 QERSHORIT 1997”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli për pranimin e Komunitetit Europian në Konventën Ndërkombëtare të EUROKONTROLLIT, për bashkëpunimin për sigurinë e navigimit ajror të 13 dhjetorit 1960, të ndryshuar me anë të amendimit dhe të konsoliduar nga Protokolli i 27 qershorit 1997”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5093, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

PROTOKOLL

MBI PRANIMIN E KOMUNITETIT EUROPIAN NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE TË EUROKONTROLLIT NË LIDHJE ME KOOPERIMIN PËR SIGURINË E NAVIGIMIT AJROR TË 13 DHJETORIT 1960, DHE I NDRYSHUAR, ME ANË TË AMENDIMIT DHE I KONSOLIDUAR NGA PROTOKOLLI I 27 QERSHORIT 1997.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA FEDERALE E GJERMANISË
REPUBLIKA E AUSTRISË
MBRETËRIA E BELGJIKËS
REPUBLIKA E BULLGARISË
REPUBLIKA E QIPROS
REPUBLIKA E KROACISË
MBRETËRIA E DANIMARKËS
MBRETËRIA E SPANJËS
REPUBLIKA E FINLANDËS
REPUBLIKA E FRANCËS
MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT
REPUBLIKA E GREQISË

REPUBLIKA E HUNGARISË
IRLANDA
REPUBLIKA E ITALISË
ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË
DUKATI I MADH I LUKSEMBURGUT
REPUBLIKA E MALTËS
REPUBLIKA E MOLDOVËS
PRINCIPATA E MONAKOS
MBRETËRIA E NORVEGJISË
MBRETËRIA E HOLANDËS
REPUBLIKA E PORTUGALISË
RUMANIA
REPUBLIKA E SLLOVAKISË
REPUBLIKA E SLLOVENISË
MBRETËRIA E SUEDISË
KONFEDERATA E ZVICRËS
REPUBLIKA E ÇEKISË
REPUBLIKA E TURQISË
DHE
KOMUNITETI EUROPIAN

Në lidhje me Konventën Ndërkombëtare të Eurokontrollit për Kooperimin për Sigurinë e Navigimit Ajror të 13 dhjetorit 1960, të amenduar nga Protokollit Shtesë i 6 korrikut 1970, më vonë i amenduar nga Protokollit i 21 nëntorit 1978 dhe të gjitha të amenduara nga Protokollit i 12 shkurtit 1981, si dhe të amenduara dhe të konsoliduara nga Protokollit i 27 qershorit 1997, këtej e tutje i referuar si "Konventa" dhe në veçanti neni 40;

në lidhje me përgjegjësitë e dhëna nga Traktati i vendosur i Komunitetit European i 25 marsit 1957, dhe i rishikuar nga Traktati i Amsterdamt i 2 tetorit 1997, për Komunitetin European në disa zona të caktuara të mbuluara nga Konventa;

ndërsa shtetet anëtare të Komunitetit European, Anëtarët e Eurokontrollit, me adoptimin e protokollit të konsolidimit të Konventës, e cila është hapur për nënshkrim më 27 qershor 1997, deklaruan se nënshkrimet e tyre nuk paragjykojnë kompetencat ekskluzive të Komunitetit në disa zona të caktuara të mbuluara nga Konventa dhe të anëtarësisë së Eurokontrollit për qëllim të ushtrimit të kompetencave të tilla ekskluzive;

ndërsa për qëllim të pranimit të Komunitetit European, kjo Konventë është që të ndihmojë Organizatën Europiane për Sigurinë e Navigimit Ajror, këtej e tutje e referuar si "Eurokontroll", për arritjen e objektivave të vendosura në Konventë, për të qenë një bord i dallueshëm, i vetëm dhe eficient për menaxhimin e trafikut ajror të politikëbërjes në Europë;

ndërsa pranimi i Komunitetit European në Eurokontroll kërkon sqarimin e mënyrës në të cilën parashikimet e Konventës do të aplikohen te Komuniteti European dhe te shtetet e tij anëtare;

ndërsa termat dhe kushtet e pranimit të Komunitetit European në Konventë do ta aftësojnë Komunitetin të ushtrojë brenda Eurokontrollit kompetenca të tilla, që janë transferuar tek ai nga shtetet e tij anëtare;

ndërsa marrëveshjet për kooperimin më të gjerë mbi përdorimin e aeroportit të Gjibraltarit i pranuar në Londër më 2 dhjetor 1987 nga Mbretëria e Spanjës dhe Mbretëria e Bashkuar me një delegacion të përbashkët nga Ministrat e Punëve të Jashtme të të dyja vëndeve dhe marrëveshjeve të tilla, duhet të futen në operim,

kanë pranuar si më poshtë:

Neni 1

Komuniteti European, brenda suazës së kompetencës së tij pranuan në Konventë termat dhe kushtet e shtruar në këtë Protokoll, në përputhje me nenin 40 të Konventës.

Neni 2

Për Komunitetin European, brenda suazës së kompetencës së tij, Konventa do të aplikojë shërbimet e navigimit në rrugë, si dhe shërbimet e aerodromit për trafikun ajror në rajonet e informacionit të fluturimeve të shteteve anëtare të tij, që janë në listë në aneksin II të Konventës, të cilat janë brenda kufizimeve të aplikimit territorial të traktatit të vendosur të Komunitetit European.

Aplikimi i Protokollit për aeroportin e Gjibraltarit kuptohet se do të kryhet pa paragjykime në lidhje me pozicionin legal respektiv të Mbretërisë së Spanjës dhe të Mbretërisë së Bashkuar në lidhje me mosmarrëveshjet

mbi sovranitetin mbi territorin në të cilin aeroporti është vendosur.

Aplikimi i këtij Protokolli mbi aeroportin e Gjibraltarit do të pezullohet derisa rregullimet në deklaratën e përbashkët bërë nga Ministrat e Jashtëm të Mbretërisë së Spanjës dhe të Mbretërisë së Bashkuar më 2 dhjetor 1987 të futen në operim. Qeveria e Spanjës dhe Mbretëria e Bashkuar do të informojnë Palët e tjera Kontraktuese për këtë Protokoll në datën e futjes në operim.

Neni 3

Subjekt i parashikimeve të këtij Protokolli, parashikimet e Konventës do të interpretohen në atë mënyrë që të përfshihet Komuniteti European brenda suazës së kompetencës së Komunitetit, dhe termat e ndryshëm të përdorur për të përcaktuar Palët Kontraktuese në Konventë dhe përfaqësuesit e tyre të nënkuptohen në mënyrë respektive.

Neni 4

Komuniteti European nuk do të kontribuojë në buxhetin e Eurokontrollit.

Neni 5

Pa paragjykuar ushtrimin e të drejtave të tij të votuara sipas nenit 6, Komuniteti European do të titullohet për të qenë prezent dhe të përfshihet në punën e të gjitha bordeve të Eurokontrollit, në të cilën ndonjëra nga shtetet anëtare është titulluar të jetë prezent si një Palë Kontraktuese, dhe kur çështjet bien brenda kompetencës së tij duhet të merret me të, me përjashtim të bordeve të cilat kanë një funksion auditimi.

Në të gjitha bordet e Eurokontrollit, ku ata mund të marrin pjesë, Komuniteti European do të prezantojë pozicionin e tij, brenda suazës së kompetencave të tij, në përputhje me rregullat e tij institucionale.

Komuniteti European nuk mund të dorëzojë kandidatë për anëtarësi për bordet e zgjedhura të Eurokontrollit, ai nuk mund të dorëzojë kandidatë për zyra në bordet në të cilat është titulluar të marrë pjesë.

Neni 6

1. Për vendimet në çështjet ku Komuniteti European ka kompetenca ekskluzive dhe për qëllim të aplikimit të rregullave të parashikuara në nenin 8 të Konventës, Komuniteti European do të ushtrojë të drejtat e votimit të shteteve të tij anëtare sipas Konventës, si dhe votat dhe peshën e votave të Komunitetit European do të përdoren për përcaktimin e maxhorancës si është parathënë në nenin 8 të Konventës. Kur Komuniteti voton, shtetet e tij anëtare nuk duhet të votojnë:

Për qëllim të vendosjes së numrit të Palëve Kontraktuese sipas kërkesës së Konventës për marrjen e vendimeve nga një e treta e maxhorancës, si është stipuluar në fund të nënparagrafit të parë të nenit 8.2, Komuniteti do të konsiderohet se përfaqëson shtetet e tij anëtare, të cilat janë anëtare të Eurokontrollit.

Një vendim i propozuar në lidhje me një çështje specifike, që do të votohet në Komunitetin European, duhet të shtyhet në një Palë Kontraktuese të Konventës, që nuk është anëtar i Komunitetit European nëse kërkohet në këtë mënyrë. Shtyrja duhet të përdoret për konsultime ndërmjet Palëve Kontraktuese në Konventë, të ndihmuara nga Agjencia e Eurokontrollit, mbi vendimin e propozuar. Në rast të një kërkesë të tillë, marrja e një vendimi mund të shtyhet për një periudhë maksimumi prej gjashtë muajsh.

2. Për vendimet në çështjet ku Komuniteti European nuk ka kompetenca ekskluzive, shtetet anëtare të Komunitetit European duhet të votojnë në përputhje me të drejtat e tyre të votimit sipas parashikimit në nenin 8 të Konventës, dhe Komuniteti European nuk duhet të votojë.

3. Komuniteti European duhet të informojë mbi një bazë rast pas rasti Palët e tjera Kontraktuese në Konventë të rasteve ku, në lidhje me çështje të ndryshme të agjendës së Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli dhe bordet e tjera deliberative, në të cilat Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli kanë deleguar fuqitë e tyre, do të ushtrojnë të drejtat e votimit, sipas parashikimit të nënparagrafit 1 më sipër. Këto detyrime gjithashtu duhet të aplikohen kur vendimet janë marrë me korrespondencë.

Neni 7

Qëllimi i kompetencave të transferuara te Komuniteti është treguar në terma të përgjithshëm në një deklaratë me shkrim të përgatitur nga Komuniteti European në kohën e nënshkrimit të këtij Protokolli.

Kjo deklaratë mund të modifikohet përkatësisht me anë të njoftimit nga Komuniteti European tek Eurokontrolli. Ajo nuk zëvendëson ose në ndonjë mënyrë të kufizojë çështje të cilat mund të mbulohen nga njoftimet e Komunitetit, që ka kompetenca t'i bëjë para vendimmarrjes së Eurokontrollit me anë të votimit formal ose në ndonjë formë tjetër të ndryshme.

Neni 8

Neni 34 i Konventës duhet të aplikohet për çdo mosmarrëveshje të ngritur ndërmjet dy ose më shumë Palëve Kontraktuese dhe Eurokontrollit në lidhje me interpretimin, aplikimin ose zbatimin e këtij Protokollit, përfshi ekzistencën e tij, vlefshmërinë dhe përfundimin.

Neni 9

1. Protokollit do të hapet për nënshkrim nga shtetet nënshkruese të Protokollit, që konsolidon Konventën Ndërkombëtare të Eurokontrollit në lidhje me kooperimin për sigurinë e navigimit ajror të 13 dhjetorit 1960, i ndryshuar me amendimet, i hapur për nënshkrim më 27 qershor 1997, këtej e tutje i referuar si "Protokoll i konsolidimit" dhe Komunitetit Europian.

Ai gjithashtu do të jetë i hapur para datës së futjes së tij në forcë për nënshkrim nga ndonjë shtet i autorizuar plotësisht të nënshkruajë Protokollin e konsolidimit, në përputhje me nenin 11 të këtij Protokollit.

2. Ky Protokoll do të jetë subjekt i ratifikimit, pranimi ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose miratimit do të depozitohen nga Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës.

3. Ky Protokoll do të futet në fuqi, pasi ai të jetë ratifikuar, pranuar ose miratuar, nga njëra anë, nga shtetet nënshkruese, të cilat janë gjithashtu nënshkruese të Protokollit të konsolidimit, dhe nga të cilat kërkohet ratifikimi, pranimi ose miratimi për futjen në fuqi të Protokollit të konsolidimit, dhe nga ana tjetër, nga Komuniteti Europian, në ditën e parë të muajit të dytë pas depozitimit të instrumentit të fundit të ratifikimit, pranimi ose miratimit, që Protokollit i konsolidimit të futet në fuqi në këtë datë. Në rast se ky kusht nuk është plotësuar, ai do të futet në fuqi në të njëjtën datë si dhe Protokollit i konsolidimit.

4. Ky Protokoll do të futet në fuqi në lidhje me nënshkrues të tillë, që kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimi ose miratimit pas futjes në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë në vijim të depozitimit të instrumenteve përkatës të ratifikimit, pranimi ose të miratimit.

5. Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës duhet të njoftojë qeveritë e shteteve të tjera nënshkruese të këtij Protokollit dhe Komunitetin Europian të çdo nënshkruesi, të çdo depozitimi të instrumentit të ratifikimit i pranimi ose miratimit dhe çdo datë të futjes në fuqi të këtij Protokollit në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 më sipër.

Neni 10

Çdo pranim në Konventë pas futjes së saj në fuqi do të përfaqësojë gjithashtu pëlqimin për të qenë i lidhur nga ky Protokoll. Parashikimet e nenit 39 dhe 40 të Konventës gjithashtu do të aplikohen në këtë Protokoll.

Neni 11

1. Ky Protokoll do të mbetet në fuqi për një periudhë të pakufizuar.

2. Nëse të gjitha shtetet anëtare të Eurokontrollit, të cilat janë anëtare të Komunitetit Europian tërhiqen nga Eurokontrolli, njoftimi i tërheqjes nga Konventa, gjithashtu dhe nga ky Protokoll do të konsiderohet si i dhënë nga Komuniteti Europian së bashku me njoftimin e tërheqjes sipas nenit 38.2 të Konventës të shtetit të fundit anëtar të Komunitetit Europian të tërhequr nga Eurokontrolli.

Neni 12

Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës duhet ta regjistrojë këtë Protokoll me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe me Këshillin e Organizatës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar, në përputhje me nenin 83 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, nënshkruar në Çikago më 7 dhjetor 1944.

LIGJ

Nr.9620, datë 16.10.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SHUMËPALËSHE "PËR NGRITJEN E NJË RRJETI HEKURUDHOR, TË PERFORMANCËS SË LARTË, NË EUROPËN JUGLINDORE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja shumëpalëshe “Për ngritjen e një rrjeti hekurudhor, të performancës së lartë, në Europën Juglindore””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5094, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJA

MBI NGRITJEN E NJË RRJETI HEKURUDHOR TË PERFORMANCËS SË LARTË NË EUROPËN JUGLINDORE
(ATHINË, 27 JANAR 2006)

Ministrat përgjegjës për bashkërendimin e aktivitetit të transportit në vendet e procesit të bashkëpunimit të Europës Juglindore (SEECp), këtu e tutje të referuara si “Palët”:

- *të ndërgjegjshëm* që një sistem transporti efikas është thelbësor për zhvillimin ekonomik dhe social të Europës Juglindore;

- *me dëshirën* për të shfrytëzuar avantazhet e natyrshme të hekurudhës mbi llojet e tjera të transportit për lloje të caktuara të udhëtimit dhe për të përmbysur rënien në pjesët modale që transporti hekurudhor ka pësuar në dekadat e fundit;

- *të vetëdijshëm* që rrjeti aktual hekurudhor vuan nga një shpejtësi e ulët përfituese (60 km/h), kapacitet i pamjaftueshëm në linjat kryesore ndërmjet qendrave kryesore urbane, vonesa të tepëra në kalimet kufitare, nga cilësia e ulët e shërbimit për transportin e udhëtarëve, ngarkesave dhe transportit intermodal dhe që ka nevojë për përmirësime përkatëse legislative;

- *duke reflektuar* mbi vështirësitë që ende ndeshen nga transporti hekurudhor në kalimet kufitare, të cilat janë të dëmshme për lëvizjen efiçente të udhëtarëve dhe mallrave;

- *të angazhuar* për të arritur sinergji ndërmjet përpjekjeve që ata ndërmarrin për të përmirësuar cilësinë dhe shpejtësinë e transportit hekurudhor në të gjithë rrjetin, duke bashkërenduar aktivitetet e tyre;

- *duke pasur parasysh* që zhvillimi i një rrjeti të vërtetë të shpejtësisë së lartë është një qëllim afatgjatë që e kanë të gjithë;

- *të bindur* që në mënyrë që të vendosen bazat për realizimin e mundshëm të një rrjeti të vërtetë të shpejtësisë së lartë, Palët duhet të realizojnë në periudhën nga afatshkurtër në afatmesme një “Rrjet të performancës së lartë” me shpejtësi mesatare të rrjetit deri në 160 km/h, që pritet të arrihet sipas etapave, dhe duhet të përmbushin gjithashtu edhe specifikimet teknike për ndërveprim;

- *duke vënë re* se në çuarjen përpara të qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të ulin në mënyrë graduale kohën e udhëtimit në rrjet, duke e bërë kështu më tërheqëse për udhëtarët;

duke marrë në konsideratë se kohët e udhëtimit të reduktuara në mënyrë graduale do ta bëjnë më tërheqës rrjetin hekurudhor për trafikun e mallrave;

- *duke theksuar* gatishmërinë e tyre për të mundësuar, në kuadrin e skemave kombëtare ose ndërkombëtare të financimit, investimet e kërkuara për të realizuar përmirësime në rrjet dhe mjetet e lëvizshme, me qëllim që të zbatohet një politikë kombëtare e investimeve të drejtpërdrejta në mjetet e lëvizshme, për të arritur një zgjidhje të plotë dhe përmirësuar nivelet e shërbimit;

- *duke pohuar* gatishmërinë e tyre për të respektuar dispozitat ekzistuese ligjore, të cilat rregullojnë transportin hekurudhor dhe veçanërisht legjislacionin e BE-së dhe normat e UN/ECE;

- *duke vënë re* angazhimet e disa palëve, që lindin nga anëtarësimi ose anëtarësimi i tyre i mundshëm në BE;

- *të vetëdijshëm* për angazhimet e tyre që rrjedhin nga marrëveshjet shumëpalëshe (për shembull AGC dhe AGTC) dhe konventat kryesore (për shembull COTIF) në fushën e transportit hekurudhor, si dhe nga marrëveshjet dypalëshe;

- *duke garantuar* mbështetjen e tyre të plotë për strukturën e menaxhimit të projektit të përshkruar më poshtë në këtë Marrëveshje, në mënyrë që të lehtësojë rolin e saj për të siguruar zbatimin e një programi

koherent, efektiv, eficient dhe transparent të aktiviteteve,
kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi

Kjo Marrëveshje ka për qëllim zbatimin në Europën Juglindore të një rrjeti të performancës së lartë të hekurudhave për transportin për udhëtarët, ngarkesat dhe transportin intermodal, duke ofruar ndërlidhje hekurudhore më konkurruese, me kohë shumë më të shkurtër ndërmjet qendrave kryesore urbane dhe tregtare.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo Marrëveshje zbatohet për akset hekurudhore në Europën Juglindore që mendohen të jenë të një cilësie të lartë për t'u përfshirë në rrjetin e performancës së lartë dhe që përmbushin disa kritere cilësie, të caktuara nga komiteti drejtues. Për shembull:

- Akset që janë pjesë e rrjetit transeuropian, korridoreve paneuropiane ose aksit juglindor;
- Akset që priten të arrijnë një shpejtësi të planifikuar prej 160 km/h deri në vitin 2020, në fazat të cilat do të përcaktohen nga komiteti drejtues i referuar në nenin 4.

Rrjeti i performancës së lartë përbëhet nga 16 akse hekurudhore të identifikuar më poshtë dhe në hartën e rrjetit në shtojcën bashkëlidhur.

1.	Athinë – Selanik – Shkup – Nish – Beograd – Zagreb (Ljubljana – Salzburg)
2.	(Budapest –) Subotica – Beograd – Dimitrovgrad – Sofie – Plovdiv – Stamboll – Ankara – Adana/Sivas
3.	Konstancë – Bukuresht – Brasov – Arad (-Vjenë)
4.	Durrës – Tirana – Qafë-Thanë – Kicevo – Shkup – Kriva Palanka – Gueshevo – Sofia – Plovdiv – Stara Zagora – Varna/Burgas
5.	Strymonas – Kulata – Sofie - Gorna Oryahovica -Varna
6.	Veles–Bitola–Florina–Amyntaio/Kalambaka–Janinë–Igumenicë/Selanik
7.	Selanik – Pehlivankoy - Stamboll – Eskisehir – Izmir
8.	Ploce - Sarajevë – Vrpolje – Osijek (-Budapest)
9.	Bar - Potgoricë – Beograd
10.	Podgoricë – Tirana-Durrës
11.	Bukuresht – Krajove – Timisoara/Arad – Beograd
12.	Krajove – Calafet – Vidin – Sofia
13.	(Kuchurgan) – Chisinau – Ungheni – Iasi – Pascani – Bukuresht – Giurgiu – Russe – Gorna Oryahovica – Stara Zagora – Pythion
14.	(Budapest -) Zagreb – Rijeka
15.	Zagreb- (Maribor-Graz)
16.	(Zagreb)-Dobrljin-Banjaluka-Doboj-Tuzla- (Beograd)

Neni 3

Shpejtësia përfituese

Shpejtësia përfituese e rrjetit të performancës së lartë (siç përshkruhet më sipër në nenin 2) është të paktën 130 km/h për trenat e udhëtarëve me një shpejtësi minimale të projektuar prej 160km/h (që rritet deri në 220km/h në seksione të caktuara, ku të jetë e mundur) për operimin me trenat më të shpejtë.

Palët e kësaj Marrëveshjeje do të marrin të gjitha masat dhe iniciativat për arritjen e këtij objekti.

Shpejtësia përfituese për trenat e mallrave do të rregullohet përkatësisht, në lidhje me shpejtësinë e trenave të udhëtarëve.

Neni 4

Bashkërendimi dhe zbatimi

Një komitet drejtues, i përbërë nga përfaqësues të Palëve dhe organizatat e tyre kombëtare të hekurudhave, krijohet mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje.

Objektivat e komitetit drejtues janë: identifikimi, koordinimi, mbështetja, lehtësimi, monitorimi dhe rishikimi i zbatimit të veprimeve të kërkuara për arritjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

Komiteti drejtues cakton kryetarin e tij të parë në mbledhjen e parë. Kryesia kalon me rotacion midis Palëve, sipas përshkrimit në rregullat procedurale.

Komiteti drejtues mbledhet një herë në vit (ose më shpesh, nëse kërkohet).

Ai miraton me unanimitet rregullat procedurale, pasi të jenë miratuar nga Palët.

Përfaqësuesit e sektorit privat të institucioneve ndërkombëtare financiare dhe organeve të tjera, si dhe zyrtarë vendas mund të ftohen në mbledhjet e komitetit drejtues, sipas rastit.

Komiteti drejtues ngre një sekretariat teknik për të dhënë mbështetje teknike dhe me informacion, sipas nevojës.

Gjuha e punës së komitetit drejtues është anglishtja.

SERG (Grupi i Hekurudhave të Europës Juglindore) i UIC (Unioni Ndërkombëtar i Hekurudhave) dhe organizata të tjera kompetente mund të përfshihen, gjithashtu, në arritjen e këtyre objektivave.

Neni 5

Standardet minimale teknike

Palët, nëpërmjet një komiteti drejtues, vendosin një grup standardesh të përbashkëta teknike për të cilat ata sigurojnë që seksionet e rrjetit të performancës së lartë që zbatohen brenda territorit të tyre, të jenë të përputhshme.

Palët asistohen në arritjen e këtyre standardeve teknike nga aktivitetet e komitetit drejtues për të vendosur specifikime teknike të përbashkëta, për të vendosur dhe menaxhuar një regjistër të kërkesave teknike nga Palët e kësaj Marrëveshjeje dhe zëra për përfshirjen në programin e punimeve kryesore, si ato në lidhje me infrastrukturën, mjetet e lëvizshme, ndëroperimin dhe kontrollet kufitare, për të vlerësuar kostot e punimeve kryesore dhe iniciativave, për të siguruar asistencë teknike për Palët, për të shpejtuar paraqitjen e teknologjive novatore dhe praktikave të menaxhimit të rrjetit dhe për të siguruar të dhëna teknike dhe kartografike për të mbështetur hartimin e dokumenteve të vlerësimit.

Neni 6

Përmirësime ndaj cilësisë së shërbimit

Palët bien dakord të identifikojnë dhe ekzekutojnë, kur është e mundur, nëpërmjet agjencisë së organizatave të tyre kombëtare hekurudhore dhe ndërmarrjeve hekurudhore, që operojnë në territoret e tyre, masat fizike dhe jofizike për të përmirësuar nivelin e përgjithshëm të cilësisë së shërbimit, i provuar nga përdoruesit e rrjetit.

Masat dhe iniciativat e ndërmarra me objektivin e përmirësimit të cilësisë së shërbimit mund të përfshijnë rritjen e frekuencave të shërbimit, rinovimin ose përmirësimin e mjeteve të lëvizshme dhe infrastrukturës në dhe përreth stacioneve, lehtësimin dhe përmirësimin e cilësisë së çdo procedure kontrolli dokumentesh ose procedurave doganore të kërkuara për udhëtarët në udhëtimet ndërkombëtare dhe dhënien e shërbimeve të cilësisë së lartë për klientin para dhe pas shitjeve (për shembull shitja e biletave nëpërmjet internetit, faturë elektronike e shoqërimit të mallit, dorëzimi në shtëpi etj.).

Neni 7

Eliminimi i vonesave në kalimet kufitare

Palët ndërmarrin të eliminojnë vonesat e tepërta të trenave në kalimet kufitare, duke identifikuar dhe ekzekutuar masat dhe iniciativat që do të zvogëlojnë kohën e kërkuar për të plotësuar procedurat e kalimeve kufitare dhe/ose duke zbatuar përmirësime për infrastrukturën hekurudhore dhe të kalimeve kufitare, të cilat lehtësojnë kalimin e efektshëm të trenave dhe udhëtarëve në kufi (për shembull arritja e sistemeve të transmetimit të të dhënave për dhënien e informacionit në kufi para arritjes së trenave). Ato marrin përsipër gjithashtu të arrijnë/përmirësojnë marrëveshjet për kalimin e kufirit për trajtimin e trafikut ndërkufitar, me qëllim që të eliminojnë vonesat në pikat e kalimeve kufitare.

Në veçanti, ata ekzekutojnë në dy faza eliminimin e kërkesave për trenat që të ndalojnë për kontrollet doganore dhe të pasaportave në kalimet kufitare, duke marrë masat për kryerjen e kontrolleve të duhura gjatë udhëtimit. Në fazën e parë Palët e kësaj Marrëveshjeje do të rregullojnë reciprokisht që trenat të ndalojnë vetëm në një nga pikat e tyre kufitare që janë ballë për ballë. Në fazën e dytë ata do të rregullojnë reciprokisht eliminimin plotësisht të të gjitha kërkesave që trenat e udhëtarëve të ndalojnë për procedurat e pikës kufitare, ndërsa të gjitha procedurat e kontrollit doganor dhe pasaportave kryhen pas kësaj, gjatë udhëtimit me anë të satelitit ose teknologjive të tjera novatore.

Të gjitha aktivitetet dhe/ose masat e kryera në lidhje me këtë Marrëveshje nuk duhet të çojnë në modifikimin e ndonjë procedure të kryer nga organet e autorizuar në kufijtë e brendshëm ose të jashtëm të BE-së, siç përcaktohet nga BE-ja ose legjislacioni kombëtar. Për më tepër, këto aktivitete/masa nuk duhet të cenojnë kërkesat e sigurisë për të luftuar kundër të gjitha formave të kontrabandës, migrimit të paligjshëm, trafikimit të qenieve njerëzore, armëve dhe lëndëve narkotike.

Neni 8

Menaxhimi i projektit

Komiteti drejtues lehtëson bashkërendimin efektiv të aktiviteteve të ndërmarra nga Palët brenda kontekstit të Marrëveshjes, duke hartuar një program të detajuar të veprimeve që do të ndërmerren, duke monitoruar zbatimin e programit, duke identifikuar shmangiet nga programi dhe duke ndërhyrë për zgjidhjen e këtyre shmangieve.

Neni 9

Financimi

Komiteti drejtues asiston Palët (dhe autoritetet e tyre përkatëse) për të kryer, në lidhje me planifikimin e investimeve, vlerësime të plota ekonomike dhe përgatitjen e dokumenteve të vlerësimit. Për më tepër komiteti drejtues heton burimet potenciale të financimit, të cilat mund të përfshijnë fondet publike kombëtare, burimet ndërkombëtare (BE, Banka Europiane e Investimeve, etj.) dhe financime private, dhe ndërmarrin veprimet e nevojshme për të siguruar financim nga këto burime për investim në mjetet e lëvizshme, në teknologjitë novatore dhe në rrjetin e performancës së lartë.

Neni 10

Komunikimet

Komiteti drejtues asiston secilën nga Palët të hartojë një plan promovues për të rritur kujdesin për rrjetin e performancës së lartë dhe të sigurojë mbështetje politike, publike dhe financiare për iniciativat dhe masat e ndërmarra brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, Palët dhe autoritetet kombëtare të hekurudhave i sigurojnë komitetit drejtues të dhënat e kërkuara statistikore, vëzhguese, teknike, financiare dhe operacionale.

Neni 11

Dispozitat përfundimtare

Marrëveshja hyn në fuqi datën kur të paktën dy të tretat e Palëve të kenë njoftuar depozitarin, nëpërmjet rrugëve diplomatike, në lidhje me përfundimin e procedurave përkatëse të brendshme.

Qeveria e Bullgarisë vepron si depozitare për këtë Marrëveshje.

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të amendohen nëse njëra nga Palët e kërkon këtë me shkrim. Amendimet e propozuara diskutohen dhe finalizohen në komitetin drejtues dhe më pas konkludohen nga marrëveshja e të gjitha Palëve. Secili prej këtyre mendimeve do të hyjë në fuqi sipas procedurës së parashtruar në paragrafin e parë të këtij neni.

Ministritë përgjegjëse për bashkërendimin e aktiviteteve të transportit të shteteve fqinje mund të aplikojnë për të qenë pjesë e kësaj Marrëveshjeje, me anë të dorëzimit të një kërkesë komitetit drejtues. Me votë unanime, komiteti mund të pranojë kërkesën për të aderuar në Marrëveshje. Pas kësaj, data e aderimit të saj në Marrëveshje do të jetë data e marrjes nëpërmjet rrugëve diplomatike e njoftimit ndaj depozitarit, në lidhje me përfundimin e procedurave përkatëse të brendshme.

Bërë në Selanik më 4 maj 2006, në një kopje origjinale në gjuhën angleze.

Për Palët e kësaj Marrëveshjeje:

Z. Lulzim Basha	Firma
Ministër i Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit	

Z. Branko Dokic	Firma
Ministër i Komunikacionit dhe Transportit	

Z. Petar Vassilev Mutafchiev	Firma
Ministër i Transportit	

Z. Bozidat Kalmeta	Firma
--------------------	-------

Ministër i Detit, Turizmit, Transportit
dhe Zhvillimit

Z. Xhemali Mehazi Firma

Ministër i Transportit dhe Komunikacionit

Z. Michael Liapis Firma

Ministër i Transportit dhe Komunikacionit

Z. Septimiu Buzasu Firma

Sekretar i Shtetit i Ministrisë së

Transportit, Ndërtimeve dhe Turizmit

Z. Vuk Draskovic Firma

Ministër i Punëve të Jashtme

Z. Rados Sucur Firma

Zv.ministër i Ministrisë së Punëve

Detare & Transportit

Z. Binali Yildirim Firma

Ministër i Transportit

Z. Miron Gagauz Firma

Ministër i Transportit dhe Ekonomisë

Rrugore

Kopje e vërtetuar

Emilena POPOVA

Drejtor, Drejtoria e Legjislacionit Ndërkombëtar

Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Bullgarisë

Firma, Vula

LIGJ

Nr.9621, datë 16.10.2006

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË SHETIT TË VITIT 2005

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet Buxheti faktik i Shtetit i vitit 2005 dhe burimet e tij të financimit, si më poshtë:

Në milionë/lekë

1. Fondi i konsoliduar	
- Të ardhurat, gjithsej	167 970,27
- Shpenzimet, gjithsej	195 683,43
2. Buxheti i sigurimeve shoqërore	
- Të ardhurat	48 856,66
- Shpenzimet	49 006,02
3. Buxheti i sigurimeve shëndetësore	
- Të ardhurat	6 556,62
- Shpenzimet	6 870,36
4. Deficiti buxhetor	28 176,27
5. Financimi i deficitit buxhetor	28 176,27

- I brendshëm	23 298,30
	Në milionë/lekë
A. Me instrumente financiare (kredimarrje e brendshme neto)	20 617,13
- Kredi nga Banka e Shqipërisë	
- Bono thesari	4 046,80
- Obligacione qeveritare 2-vjeçare	24 663,94
B) Të ardhura nga privatizimi	886,62
C) Të tjera	1 794,55
- Ndryshimi i gjendjes së arkës	512,81
- Të tjera	1 281,55
- I jashtëm neto	4 877,97
Nga i cili:	
- Mbeshtetje buxhetore	367,50

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5095, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9622, datë 16.10.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES USHTARAKE GRANT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ushtarake grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5096, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE USHTARAKE GRANT
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Turke, duke riafirmuar marrëdhëniet e gjata ekzistuese të miqësisë;

- duke iu referuar Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën ushtarake të stërvitjes, teknikës dhe

shkencës, nënshkruar më 29.7.1992 dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe trajnimit ushtarak, nënshkruar më 19.11.1992;

- *me qëllim* forcimin e bashkëpunimit ushtarak dhe kontributit për rristurimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë,
bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qeveria e Republikës së Turqisë do t'i dhurojë 1 360 000 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lira të reja turke të barasvlefshme në dollarë amerikanë, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Granti do të jetë i vlefshëm për vitin 2006.

Neni 2

1 360 000 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lira të reja turke e barasvlefshme në dollarë amerikanë do të sigurohen si materiale dhe shërbime, në përputhje me rregullat në fuqi të Republikës së Turqisë.

Neni 3

1 360 000 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lira të reja turke e barasvlefshme në dollarë amerikanë do të realizohen në përputhje me protokollin e zbatimit logjistik dhe do të nënshkruhet ndërmjet autoriteteve të të dyja Palëve referuar kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Republika e Shqipërisë bie dakord të mos ia transferojë titujt, materialet, shërbimet një vendi apo pale të tretë pa pasur më parë miratimin e Republikës Turke.

Neni 5

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën kur Palët kanë shkëmbyer ndërmjet tyre njoftimet me shkrim, duke deklaruar se marrëveshja është ratifikuar në përputhje me procedurën e tyre ligjore dhe do të jetë në fuqi derisa të gjitha materialet dhe shërbimet e specifikuar në protokollin e zbatimit i janë dhënë Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.

Marrëveshja grant do të zbatohet nga Ministria e Mbrojtjes në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe nga Shtabi i Përgjithshëm Turk në emër të Qeverisë së Republikës Turke.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet diskutimeve dhe negociatave reciproke.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në gjuhët turqisht, anglisht dhe shqip. Në rast të mosmarrëveshjeve lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, versioni në anglisht do të jetë prioritar.

Kjo Marrëveshje u nënshkrua më 12 korrik 2006 në Ankara/Turqi.

NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

NË EMËR TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
TURQISË

Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve të
Mbrojtjes

Drejtor i Departamentit të Planizimit dhe Menaxhimit
të Burimeve të Mbrojtjes të SHPFA të Turqisë

**Kolonel
Perikli Koliçi**

**Gjeneral Brigade
Ali Akdogan**

**LIG J
Nr.9623, datë 16.10.2006**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE
KUNDËR DOPINGUT NË SPORT, 2005**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Ndërkombëtare kundër dopingut në sport, 2005.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5097, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

**KONVENTA NDËRKOMBËTARE
KUNDËR DOPINGUT NË SPORT, 2005
Paris, 19 tetor 2005**

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Kulturore, Shkencore dhe Arsimore e Kombeve të Bashkuara, që këtu quhet “UNESCO”, që mbahet në Paris nga 3 deri 21 tetor 2005, në sesionin e saj të 33-të:

- *duke pasur parasysh* se qëllimi i UNESCO-s është të kontribuojë për paqen dhe sigurinë duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet kombeve me anë të arsimit, shkencës dhe kulturës;
- *duke iu referuar* instrumenteve ekzistuese ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut;
- *duke ditur* rezolutën 58/5 të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 3 nëntor 2003, në lidhje me sportet, si një mjet për nxitjen e arsimit, shëndetit, zhvillimit dhe paqes, siç është paragrafi 7 i saj;
- *të ndërgjegjshëm* se sporti duhet të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e shëndetit, në edukimin moral, kulturor dhe fizik, dhe në nxitjen e mirëkuptimit ndërkombëtar dhe paqes;
- *duke vënë re* nevojën për të inkurajuar dhe bashkërenduar bashkëpunimin ndërkombëtar drejt eliminimit të dopingut në sport;
- *e shqetësuar* nga përdorimi i dopingut nga atletët në sport dhe pasojat e tij për shëndetin e tyre, principin e lojës së drejtë, eliminimin e mashtrimit dhe të ardhmen në sport;
- *duke ditur* se dopingu vë në rrezik principet etike dhe vlerat edukative që mishërohen në Kartën Ndërkombëtare të Edukimit Fizik dhe Sportit të UNESCO-s dhe në Kartën Olimpikë;
- *duke rikujtuar* se Konventa Antidoping dhe protokoli i saj shtesë, i miratuar në kuadrin e Këshillit të Europës, janë mjetet e së drejtës ndërkombëtare publike që janë në origjinën e politikave të brendshme antidoping dhe të bashkëpunimit ndërqeveritar;
- *duke rikujtuar* rekomandimet mbi dopingun, të miratuara nga Konferenca Ndërkombëtare e dytë, e tretë dhe e katërt e ministrave dhe zyrtarëve të lartë përgjegjës për edukimin fizik dhe sportin e organizuar nga UNESCO në Moskë (1988), Punta del Este (1999) dhe Athinë (2004) dhe 32C/Rezoluta 9 e miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s në sesionin e saj të 32-të (2003);
- *duke pasur parasysh* Kodin Botëror Antidoping, i miratuar nga Agjencia Botërore Antidoping në Konferencën Botërore mbi dopingun në sport, Kopenhagen, 5 mars 2003 dhe Deklaratën e Kopenhagës mbi antidopingun në sport;
- *duke ditur* gjithashtu edhe influencën që atletët elitare kanë te rinia;
- *të ndërgjegjshëm* për nevojën në vazhdim për të zhvilluar dhe nxitur kërkimin me synimin e përmirësimit të zbulimit të dopingut dhe një të kuptuar më të mirë të faktorëve që kanë efekt mbi

përdorimin me qëllim që strategjitë parandaluese të jenë me efekt të lartë;

- *të ndërgjegjshëm* gjithashtu edhe për rëndësinë e edukimit në vazhdim të atletëve, personelit në mbështetje të atletëve dhe publikut të gjerë në parandalimin e dopingut;

- *duke ditur* nevojën për ndërtimin e kapaciteteve të shteteve Palë për zbatimin e programeve antidoping;

- *të ndërgjegjshëm* se organet publike dhe organizatat përgjegjëse për sportin kanë përgjegjësi plotësuese për parandalimin dhe luftën kundër dopingut në sport, me qëllim që të arrihet zhvillimi i duhur i ngjarjeve sportive, mbi bazën e principit të lojës së drejtë, dhe të mbrohet shëndeti i atyre që marrin pjesë në to;

- *duke njohur* se këto autoritete dhe organizata duhet të punojnë së bashku për këto qëllime, duke siguruar shkallën më të lartë të pavarësisë dhe transparencë në të gjitha shkallët e duhura;

- *të vendosur* për të ndërmarrë veprim më të fuqishëm bashkëpunues, që synon eliminimin e dopingut në sport;

- *duke njohur* që eliminimi i dopingut në sport pjesërisht varet nga harmonizimi progresiv i standardeve dhe praktikave antidoping në sporte dhe bashkëpunimi në nivelet kombëtare dhe globale, miraton këtë Konventë në ditën e nëntëmbëdhjetë të tetorit 2005.

I. FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1

Qëllimi i Konventës

Qëllimi i kësaj Konvente, në kuadrin e strategjisë dhe programeve të aktiviteteve të UNESCO-s në fushën e edukimit fizik dhe sporteve, është të nxisë parandalimin dhe luftën kundër dopingut në sport, me synim eliminimin e tij.

Neni 2

Përkufizime

Këto përkufizime duhet të kuptohen në kontekstin e Kodit Botëror Andidoping. Megjithatë, në rast konflikti, dispozitat e Konventës janë prioritare.

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. “Laboratorë të akredituar për kontrollin e dopingut” janë laboratorët që janë akredituar nga Agjencia Botërore e Antidopingut.

2. “Organizatë antidoping” është një subjekt që është përgjegjës për miratimin e rregullave për fillimin, zbatimin ose ekzekutimin e çdo pjese të procesit të kontrollit të dopingut. Kjo përfshin, për shembull, Komitetin Ndërkombëtar Olimpik, Komitetin Ndërkombëtar Paraolimpik ose organizata në ngjarje madhore që kryejnë analiza në ngjarjet e tyre, Agjencia Botërore Antidoping, federatat ndërkombëtare dhe organizatat kombëtare antidoping.

3. “Shkelja e rregullit të antidopingut” në sport është një ose disa nga të mëposhtmet:

a) prania e substancës së ndaluar ose metaboliteve apo shenjave të saj në kampione prej trupit të atletit;

b) përdorimi ose tentativa për përdorimin e një substance të ndaluar ose e një metode të ndaluar;

c) refuzimi ose mosparaqitja pa pasur ndonjë justifikim bindës për mbledhjen e kampioneve pas njoftimit sipas autorizimit në pajtim me rregullat antidoping apo largimi në një mënyrë tjetër nga mbledhja e kampioneve;

d) shkelja e kërkesave të zbatueshme në lidhje me gatishmërinë e atletëve për testet jashtë gare, duke përfshirë mosdhënien e informacionit për vendndodhjen dhe moskryerjen e testeve që janë shpallur bazuar në rregulla të arsyeshme;

e) ndryshimi ose përpjekja për të ndryshuar ndonjë pjesë të kontrollit të dopingut;

f) posedimi i substancave ose metodave të ndaluara;

g) trafikimi i ndonjë substance të ndaluar ose një metode të ndaluar;

h) administrimi ose përpjekja për të administruar një substancë të ndaluar ose një metodë të ndaluar nga një atlet, apo ndihma, inkurajimi mbështetja, nxitja, fshehja apo ndonjë lloj tjetër

bashkëpunimi në lidhje me shkeljen e një rregulli antidoping apo përpjekjen për një shkelje të tillë.

4. “Atlet” për qëllimet e kontrollit të dopingut, është çdo person që merr pjesë në sport në nivel ndërkombëtar ose kombëtar sipas përkufizimit nga çdo organizatë kombëtare antidoping dhe pranuar nga Shtetet Palë dhe çdo person tjetër që merr pjesë në sport apo ngjarje në një nivel më të ulët të pranuar nga Shtetet Palë. Për qëllimet e edukimit dhe programeve të trajnimit, “atlet” është çdo person që merr pjesë në sport nën autoritetin e një organizate sportive.

5. “Personel mbështetës i atletit” është çdo stërvitës, trajner, menaxher, agjent, personel ekipi, zyrtar, personel mjekësor ose paramjekësor, që punon me ose trajton atletët që marrin pjesë ose përgatiten për garë sportive.

6. “Kod” është Kodi Botëror Antidoping i miratuar nga Agjencia Botërore Antidoping më 5 mars 2003 në Kopenhagen, i cili është bashkëngjitur si shtesa 1 e kësaj Konvente.

7. “Garë” është një garë, ndeshje, lojë e vetme ose një takim i vetëm atletik.

8. “Kontroll dopingu” është procesi që përfshin planifikimin e shpërndarjes së testit, mbledhjen dhe trajtimin e kampioneve, analizën laboratorike, menaxhimin e rezultateve, seancat dhe ankimet.

9. “Doping në sport” është ndodhia e një shkeljeje të një rregulli antidoping.

10. “Ekipet e autorizuar rregullisht për kontrollin e dopingut” janë ekipet që kontrollojnë dopingun nën autoritetin e organizatave ndërkombëtare ose kombëtare antidoping.

11. “Testim gjatë garës”, për qëllimet e diferencimit ndërmjet testimit gjatë garës dhe jashtë garës, nëse nuk parashikohet ndryshe në rregullat e një federate ndërkombëtare apo të një organizate tjetër përkatëse antidoping, është një test ku atleti zgjidhet për t’u testuar në lidhje me një garë të caktuar.

12. “Standardi ndërkombëtar për laboratorët” është standardi që është bashkëngjitur shtuar si shtesa 2 në këtë Konventë.

13. “Standardi ndërkombëtar për testim” është standardi që është bashkëngjitur si shtesa 3 në këtë Konventë.

14. “Pa njoftim paraprak” është një kontroll dopingu që ndodh pa ndonjë njoftim paraprak për atletin dhe ku atleti mbahet vazhdimisht nën mbikëqyrje nga momenti i njoftimit nëpërmjet dhënies së kampioneve.

15. “Lëvizje olimpike” janë të gjithë ata që bien dakord të drejtohen nga Karta Olimpike dhe që njohin autoritetin e Komitetit Ndërkombëtar Olimpik, veçanërisht federatat ndërkombëtare të sporteve në programin e Lojërave Olimpike, komitetet kombëtare olimpike, komitetet organizatore të lojërave olimpike, atletët, gjyqtarët dhe arbitrat, shoqatat dhe klubet, si dhe organizatat dhe institucionet e njohura nga Komiteti Ndërkombëtar Olimpik.

16. “Kontroll i dopingut jashtë gare” është çdo kontroll për doping, i cili nuk kryhet gjatë garës.

17. “Listë e ndaluar” është lista që ndodhet në aneksin I të kësaj Konvente, e cila identifikon substancat e ndaluara dhe metodat e ndaluara.

18. “Metodë e ndaluar” është çdo metodë që përshkruhet e tillë në listën e ndaluar, e cila ndodhet në aneksin I të kësaj Konvente.

19. “Substancë e ndaluar” është çdo substancë që përshkruhet e tillë në listën e ndaluar, që ndodhet në aneksin I të kësaj Konvente.

20. “Organizatë sportive” është çdo organizatë që shërben si organ vendimmarrës në një ngjarje për një ose disa sporte.

21. “Standardet për lejimin e përjashtimeve për përdorim terapisht” janë ato standarde që ndodhen në aneksin II të kësaj Konvente.

22. “Testim” janë ato pjesë të procesit të kontrollit të dopingut që përfshijnë planifikimin e shpërndarjes së testit, mbledhjen e kampioneve, trajtimin e kampioneve dhe transportin e kampioneve te laboratorit.

23. “Përjashtimi për përdorim terapisht” është një përjashtim i lejuar në pajtim me standardet për lejimin e përjashtimeve për përdorim terapisht.

24. “Përdorim” është zbatimi, gëlltitja, injektimi, ose konsumimi me çfarëdo mjeti i një prej substancave të ndaluara ose metodave të ndaluara.

25. “Agjencia Botërore Antidoping” (WADA) është organizata e quajtur kështu e themeluar në bazë të ligjit sviceran më 10 nëntor 1999.

Neni 3

Mjetet për arritjen e qëllimit të Konventës

Me qëllim që të arrihet qëllimi i Konventës, Shtetet Palë ndërmarrin:

- a) të miratojnë masa të përshtatshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, që janë në pajtim me parimet e Kodit;
- b) të inkurajojnë të gjitha format e bashkëpunimit ndërkombëtar, që synojnë mbrojtjen e atletëve dhe etikës në sport dhe bërjen të ditur të kërkimeve;
- c) të mbështesin bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet Shteteve Palë dhe organizatave udhëheqëse në luftën kundër dopingut në sport, veçanërisht me Agjencinë Botërore Antidoping.

Neni 4

Raporti i Konventës me Kodin

1. Me qëllim që të bashkërendohet zbatimi i luftës kundër dopingut në sport në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, Shtetet Palë u nënshtrohen parimeve të Kodit si bazë për masat e parashikuara në nenin 5 të kësaj Konvente. Asgjë në këtë Konventë nuk i pengon Palët të marrim masa shtesë në plotësim të Kodit.

2. Kodi dhe varianti më i fundit i shtesave 2 dhe 3 riprodhohen për qëllime informimi dhe nuk përbëjnë pjesë integrale të kësaj Konvente. Shtesat si të tilla nuk krijojnë ndonjë detyrim urdhërues në bazë të së drejtës ndërkombëtare për Shtetet Palë.

3. Anekset janë pjesë integrale e kësaj Konvente.

Neni 5

Masat për arritjen e objektivave të Konventës

Për përmbushjen e detyrimeve që parashikohen në këtë Konventë, secili Shtet Palë merr përsipër të marrë masa të përshtatshme. Këto masa mund të përfshijnë legjislacionin, rregulloret, politikat ose praktikat administrative.

Neni 6

Raporti me instrumentet e tjera ndërkombëtare

Kjo Konventë nuk i ndryshon të drejtat dhe detyrimet e Shteteve Palë që rrjedhin nga marrëveshjet e lidhura më parë dhe që përputhen me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente. Kjo nuk cenon gëzimin nga Shtetet e tjera Palë të të drejtave të tyre ose përmbushjen e detyrimeve në bazë të kësaj Konvente.

II. AKTIVITETET ANTIDOPING NË NIVEL KOMBËTAR

Neni 7

Bashkërendimi i brendshëm

Shtetet Palë sigurojnë zbatimin e kësaj Konvente, veçanërisht nëpërmjet bashkërendimit të brendshëm. Për të përmbushur detyrimet e tyre në bazë të kësaj Konvente, Shtetet Palë mund të mbështeten në organizatat antidoping, si dhe në autoritetet dhe organizatat sportive.

Neni 8

Kufizimi i pranisë dhe përdorimit në sport të substancave dhe metodave të ndaluara

1. Shtetet Palë, sipas rastit, marrin masa për kufizimin e pranisë së substancave dhe metodave të ndaluara me qëllim që të kufizohet përdorimi i tyre në sporte nga atletët, përveç rasteve të

përgjithësisht për përdorim terapeutik. Këto përfshijnë masat kundër trafikimit të atletëve dhe, për këtë qëllim, masat për të kontrolluar prodhimin, lëvizjen, importin, shpërndarjen dhe shitjen.

2. Shtetet Palë miratojnë ose nxisin, sipas rastit, subjektet përkatëse brenda juridiksionit të tyre për të marrë masa për të parandaluar dhe kufizuar përdorimin dhe zotërimin e substancave dhe metodave të ndaluara nga atletët në sport, përveç kur përdorimi bazohet në një përgjithësim për përdorim terapeutik.

3. Asnjë masë e marrë në bazë të kësaj Konvente nuk e pengon praninë për qëllimet e legjitimuara të substancave ose metodave që në çdo rast tjetër ndalohen ose kontrollohen në sport.

Neni 9

Masat kundër personelit mbështetës të atletëve

Shtetet Palë marrin vetë masa ose nxisin organizatat sportive dhe organizatat antidoping për marrjen e masave, duke përfshirë sanksionet dhe dënimet, kundër personelit në mbështetje të atletëve që bën shkelje të rregullave antidoping ose vepra të tjera penale që lidhen me dopingun në sport.

Neni 10

Shtesat ushqimore

Shtetet Palë, sipas rastit, inkurajojnë prodhuesit dhe shpërndarësit e shtesave ushqimore të vendosin praktikat më të mira në tregtimin dhe shpërndarjen e shtesave ushqimore, duke përfshirë informacionin për përbërjen e tyre analitike dhe garancinë cilësore.

Neni 11

Masat financiare

Shtetet Palë, sipas rastit:

a) japin fonde brenda buxheteve të tyre përkatëse në mbështetje të një programi kombëtar testimi në të gjitha sportet ose ndihmojnë organizatat sportive dhe organizatat antidoping në financimin e kontroleve të dopingut nëpërmjet subvencioneve ose granteve të drejtpërdrejta, ose duke njohur shpenzimet e këtyre kontroleve në caktimin e subvencioneve ose granteve të përgjithshme që u jepen këtyre organizatave;

b) marrin masa për mosdhënien e mbështetjes financiare në lidhje me sportin për ata atletë individualë ose personel në mbështetje të atletëve, të cilët janë pezulluar për shkak të shkeljes së një rregulli antidoping gjatë periudhës së pezullimit të tyre;

c) nuk u jep mbështetjen financiare ose tjetër në lidhje me sportin organizatave sportive ose organizatave antidoping që nuk përmbushin Kodin ose rregullat e zbatueshme antidoping të miratuara në pajtim me Kodin.

Neni 12

Masat për lehtësimin e kontrollit të dopingut

Shtetet Palë, sipas rastit:

a) nxisin dhe lehtësojnë zbatimin nga organizatat sportive dhe organizatat antidoping brenda juridiksionit të tyre të kontroleve të dopingut në një mënyrë që përputhet me Kodin, duke përfshirë mosbërjen e njoftimit paraprak, testimet gjatë dhe jashtë garës;

b) nxisin dhe lehtësojnë negocimin nga organizatat sportive dhe organizatat antidoping të marrëveshjeve që u lejojnë anëtarëve të tyre të testohen nga ekipet e kontrollit të dopingut të autorizuar rregullisht nga vende të tjera;

c) marrin përsipër të ndihmojnë organizatat sportive dhe organizatat antidoping brenda juridiksionit të tyre të kenë mundësinë të një laborator i akredituar për kontrollin e dopingut për qëllimet e analizave të kontrollit të dopingut.

III. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 13

Bashkëpunimi ndërmjet organizatave antidoping dhe organizatave sportive

Shtetet Palë inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet organizatave antidoping, organeve publike dhe organizatave sportive brenda juridiksionit të tyre dhe atyre brenda juridiksionit të Shteteve të tjera Palë, me qëllim që të arrihet qëllimi i kësaj Konvente në nivel ndërkombëtar.

Neni 14

Mbështetja e misionit të Agjencisë Botërore Antidoping

Shtetet Palë marrin përsipër të mbështesin misionin e rëndësishëm të Agjencisë Botërore Antidoping në luftën ndërkombëtare kundër dopingut.

Neni 15

Financimi i barabartë i Agjencisë Botërore Antidoping

Shtetet Palë mbështesin parimin e financimit të barabartë të buxhetit bazë vjetor të aprovuar të Agjencisë Botërore Antidoping nga organet publike dhe lëvizja olimpike.

Neni 16

Bashkëpunimi ndërkombëtar në kontrollin e dopingut

Duke ditur që lufta kundër dopingut në sport mund të jetë e efektshme kur atletët mund të testohen pa u njoftuar paraprakisht dhe kampionet të transportohen në kohën e duhur në laboratorë për analiza, Shtetet Palë, sipas rastit dhe në pajtim me ligjin dhe procedurat e brendshme:

a) lehtësojnë detyrën e Agjencisë Botërore Antidoping dhe të organizatave antidoping që operojnë në pajtim me Kodin, duke iu nënshtruar rregullave të vendit pritës përkatës në kryerjen e kontrolleve të dopingut brenda dhe jashtë garës të atletët e tyre, pavarësisht nëse ata janë në territorin e tyre apo gjetkë;

b) lehtësojnë lëvizjen në kohë të ekipeve të kontrollit të dopingut të autorizuar rregullisht në kalimin e kufijve gjatë kryerjes së aktiviteteve për kontrollin e dopingut;

c) bashkëpunojnë për të shpejtuar dërgimin ose kalimin e kufirit të kampioneve, në mënyrë të tillë që të ruajnë sigurinë dhe integritetin e tyre;

d) ndihmojnë në bashkërendimin ndërkombëtar të kontrolleve të dopingut nga organizata të ndryshme antidoping dhe bashkëpunojnë për këtë qëllim me Agjencinë Botërore Antidoping;

e) nxisin bashkëpunimin ndërmjet laboratorëve të kontrollit të dopingut brenda juridiksionit të tyre dhe ata brenda juridiksionit të Shteteve të tjera Palë. Veçanërisht, Shtetet Palë me laboratorë të akredituar për kontrollin e dopingut duhet të inkurajojnë laboratorët brenda juridiksionit të tyre të ndihmojnë Shtetet e tjera Palë t'u mundësojnë atyre të fitojnë eksperiencën, aftësitë dhe teknikat e nevojshme për krijimin e laboratorëve të tyre, nëse ata duan ta bëjnë këtë;

f) inkurajojnë dhe mbështesin masat reciproke të testimit ndërmjet organizatave të caktuara antidoping, në pajtim me Kodin;

g) njohin reciprokisht procedurat e kontrollit të dopingut dhe menaxhimin e rezultateve të testit, duke përfshirë sanksionet sportive të tyre, të çdo organizate antidoping që është në pajtim me Kodin.

Neni 17

Fondi vullnetar

1. Themelohet një "Fond për eliminimin e dopingut në sport", që këtu quhet "Fondi vullnetar". Fondi vullnetar përbëhet nga fonde në besim të krijuara në pajtim me rregullat financiare të UNESCO-s. Të gjitha kontributet nga Shtetet Palë dhe aktorë të tjerë janë vullnetare.

2. Burimet e fondit vullnetar përbëhen nga:

- a) kontributet e bëra nga Shtetet Palë;
- b) kontributet, dhuratat, trashëgimitë, që mund të bëhen nga:
 - i) shtete të tjera;
 - ii) organizata ose programe të sistemit të Kombeve të Bashkuara, sidomos Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin, si dhe organizatat e tjera ndërkombëtare;
 - iii) subjekte publike ose private, ose individë;
- c) të gjitha interesat e maturuara nga burimet e fondit vullnetar;
- d) fondet e krijuara nga arkëtimet dhe faturat nga aktivitetet e organizuara në favor të fondit vullnetar;
- e) çdo burim tjetër i autorizuar nga rregulloret e fondit vullnetar, të hartuara nga Konferenca e Palëve.

3. Kontributet në fondin vullnetar nga Shtetet Palë nuk konsiderohen të zëvendësojnë detyrimet e Shteteve Palë për të paguar pjesën e tyre në buxhetin vjetor të Agjencisë Botërore Antidoping.

Neni 18

Përdorimi dhe administrimi i fondit vullnetar

Burimet në fondin vullnetar caktohen nga Konferenca e Palëve për financimin e aktiviteteve të miratuara prej saj, sidomos për të asistuar Shtetet Palë në zhvillimin dhe zbatimin e programeve antidoping, në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente, duke marrë parasysh qëllimet e Agjencisë Botërore Antidoping dhe mund të shërbejnë për të mbuluar shpenzimet funksionale të kësaj Konvente. Kontributeve që i janë dhënë fondit vullnetar nuk u vihet asnjë kusht politik, ekonomik apo tjetër.

IV. EDUKIMI DHE TRAJNIMI

Neni 19

Parime të përgjithshme për edukimin dhe trajnimin

1. Shtetet Palë marrin përsipër, me mjetet e tyre, të mbështesin, hartojnë ose zbatojnë programe edukative dhe trajnuese mbi antidopingun. Për komunitetin sportiv në përgjithësi, këto programe duhet të synojnë të japin një informacion të fundit dhe të saktë mbi:

- a) dëmet e dopingut për vlerat etike të sportit;
- b) pasojat shëndetësore të dopingut.

2. Për atletët dhe personelin në mbështetje të atletëve, sidomos në trajnimin e tyre fillestar, programet edukative dhe trajnuese, përveç sa më sipër, duhet të synojnë të japin një informacion të fundit dhe të saktë për:

- a) procedurat e kontrollit të dopingut;
- b) të drejtat dhe përgjegjësitë e atletëve në lidhje me antidopingun, duke përfshirë informacion rreth Kodit dhe politikat antidoping të të gjitha organizatave përkatëse sportive dhe antidoping. Ky informacion përfshin edhe pasojat e kryerjes së shkeljes së rregullave antidoping;
- c) listën e substancave dhe metodave të ndaluara dhe përjashtimet për përdorim terapeutik;
- d) shtesat ushqimore.

Neni 20

Kodet profesionale të sjelljes

Shtetet Palë inkurajojnë shoqatat dhe institucionet kompetente profesionale për të zhvilluar dhe zbatuar kodet e përshtatshme të sjelljes, praktikës së mirë dhe etikës në lidhje me antidopingun në sport që përputhen me Kodin.

Neni 21

Përfshirja e atletëve dhe personelit në mbështetje të atletëve

Shtetet Palë nxisin dhe mbështesin me mjetet e tyre pjesëmarrjen aktive të atletëve dhe

personelit në mbështetje të atletëve në të gjitha aspektet e punës antidoping të organizatave sportive dhe të tjera përkatëse, dhe i inkurajon organizatat sportive brenda juridiksionit të tyre të bëjnë të njëjtën gjë.

Neni 22

Organizatat sportive, edukimi dhe trajnimi i vazhdueshëm antidoping

Shtetet Palë inkurajojnë organizatat sportive dhe organizatat antidoping të zbatojnë programe të vazhdueshme edukative dhe trajnuese për të gjithë atletët dhe personelin në mbështetje të atletëve për çështjet e përcaktuara në nenin 19.

Neni 23

Bashkëpunimi në edukim dhe trajnim

Shtetet Palë bashkëpunojnë reciprokisht dhe me organizatat përkatëse, sipas rastit, për shkëmbimin e informacionit, ekspertizës dhe eksperiencës mbi programet e efektshme antidoping.

V. KËRKIMET

Neni 24

Nxitja e kërkimeve antidoping

Shtetet Palë marrin përsipër, me mjetet e tyre, të inkurajojnë dhe nxisin kërkimet antidoping në bashkëpunim me organizatat sportive dhe të tjera përkatëse mbi:

- a) metodat e parandalimit dhe të zbulimit, aspekte të sjelljes dhe shoqërore, dhe pasojat shëndetësore të dopingut;
- b) mënyrat dhe mjetet e hartimit të programeve të bazuara shkencërisht fiziologjikë dhe psikologjikë duke respektuar integritetin e personit;
- c) përdorimin e të gjitha substancave dhe metodave të njohura që kanë rezultuar nga zhvillimet shkencore.

Neni 25

Natyra e kërkimeve antidoping

Gjatë nxitjes së kërkimeve antidoping, sipas parashikimit të nenit 24, Shtetet Palë sigurojnë që këto kërkime:

- a) të përputhen me praktikat etike të njohura ndërkombëtarisht;
- b) të mënjanojnë ofrimin e substancave dhe metodave të ndaluara tek atletët;
- c) të ndërmerren vetëm pas marrjes së masave të përshtatshme, me qëllim që të parandalohet keqpërdorimi apo zbatimi për dopingun i rezultateve të kërkimeve antidoping.

Neni 26

Shkëmbimi i rezultateve mbi kërkimet antidoping

Në pajtim me ligjin e brendshëm dhe ndërkombëtar, Shtetet Palë, sipas rastit, shkëmbejnë rezultatet e kërkimeve antidoping të kryera me Shtetet e tjera Palë dhe me Agjencinë Botërore Antidoping.

Neni 27

Kërkimet e sportit shkencor

Shtetet Palë inkurajojnë:

- a) anëtarët e komuniteteve shkencore dhe mjekësore të kryejnë kërkime në shkencën e sportit

në pajtim me parimet e Kodit;

b) organizatat sportive dhe personelin në mbështetje të atletëve brenda juridiksionit të tyre të zbatojnë kërkime në shkencën e sportit që përputhen me parimet e Kodit.

VI. MONITORIMI I KONVENTËS

Neni 28

Konferenca e Palëve

1. Themelohet Konferenca e Palëve. Konferenca e Palëve është organi sovran i kësaj Konvente.

2. Konferenca e Palëve mbledhet në sesione të zakonshme, parimisht, një herë në dy vjet. Ajo mund të mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm nëse ajo vendos kështu ose me kërkesën e të paktën një të tretës së Shteteve Palë.

3. Secili Shtet Palë ka një votë në Konferencën e Palëve.

4. Konferenca e Palëve miraton rregulloren e vet procedurale.

Neni 29

Organizata këshillimore dhe vëzhguesit në Konferencën e Palëve

Agjencia Botërore Antidoping ftohet si organizatë këshillimore në Konferencën e Palëve. Komiteti Ndërkombëtar Olimpik, Komiteti Ndërkombëtar Paraolimpik, Këshilli i Europës dhe Komiteti Ndërqeveritar për Edukimin Fizik dhe Sportin (CIGEPS) ftohen si vëzhgues. Konferenca e Palëve mund të vendosë të ftojë organizata të tjera përkatëse si vëzhguese.

Neni 30

Funksionet e Konferencës së Palëve

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e kësaj Konvente, funksionet e Konferencës së Palëve janë:

a) promovimi i qëllimit të kësaj Konvente;

b) diskutimi i raportit me Agjencinë Botërore të Antidopingut dhe studimi i mekanizmave për financimin e buxhetit themelor vjetor të Agjencisë. Shtetet jopalë mund të ftohen në diskutim;

c) miratimi i një plani për përdorimin e burimeve të fondit vullnetar, në pajtim me nenin 18;

d) shqyrtimi i raporteve të paraqitura nga Shtetet Palë në pajtim me nenin 31;

e) shqyrtimi i vazhdueshëm i monitorimit të respektimit të kësaj Konvente në përgjigje të sistemeve antidoping, në pajtim me nenin 31. Çdo mekanizëm ose masë monitorimi që tejkalon nenin 31, financohet nga fondi vullnetar i krijuar në pajtim me nenin 17;

f) shqyrtimi i projektndryshimeve të Konventës për miratim;

g) shqyrtimi për t'u aprovuar, në pajtim me nenin 34 të Konventës, i ndryshimeve në listën e ndaluar dhe standardet për lejimin e përjashtimeve për përdorim terapeutik i miratuar nga Agjencia Botërore Antidoping;

h) përcaktimi dhe zbatimi i bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Palë dhe Agjencisë Botërore Antidoping në kuadrin e kësaj Konvente;

i) kërkimi i një raporti nga Agjencia Botërore Antidoping mbi zbatimin e Kodit për shqyrtim në secilin nga sesionet e saj.

2. Konferenca e Palëve, në përmbushje të funksioneve të saj, mund të bashkëpunojë me organe të tjera ndërqeveritare.

Neni 31

Raportet kombëtare në Konferencën e Palëve

Shtetet Palë i paraqesin në çdo dy vjet Konferencës së Palëve, nëpërmjet Sekretariatit, në një nga gjuhët zyrtare të UNESCO-s, të gjithë informacionin përkatës në lidhje me masat e marra prej tyre për qëllimet e respektimit të dispozitave të kësaj Konvente.

Sekretariati i Konferencës së Palëve

1. Sekretariati i Konferencës së Palëve sigurohet nga Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s.
2. Me kërkesë të Konferencës së Palëve, Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s i përdor në masën më të madhe të mundur shërbimet e Agjencisë Botërore Antidoping me kushtet e aprovuara nga Konferenca e Palëve.
3. Shpenzimet funksionale në lidhje me Konventën financohen nga buxheti i zakonshëm i UNESCO-s brenda burimeve ekzistuese në një nivel të përshtatshëm, fondi vullnetar i krijuar në bazë të nenit 17 ose një kombinim i tyre, siç vendoset në çdo dy vjet.
4. Sekretariati përgatit dokumentacionin e Konferencës së Palëve, si dhe projektaxhendën e mbledhjeve të saj, dhe siguron zbatimin e vendimeve.

Ndryshimet

1. Secili Shtet Palë, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s, mund të propozojë ndryshime për këtë Konventë. Drejtori i Përgjithshëm e qarkullon këtë njoftim te të gjitha Shtetet Palë. Nëse brenda gjashtë muajsh nga data e qarkullimit të njoftimit, e jep pëlqimin të paktën gjysma e shteteve anëtare, Drejtori i Përgjithshëm e paraqet këtë propozim në sesionin tjetër të Konferencës së Palëve.
2. Ndryshimet miratohen nga Konferenca e Palëve me një shumicë prej dy të tretash të Shteteve Palë të pranishme dhe që votojnë.
3. Pas miratimit, ndryshimet e Konventës u paraqiten për ratifikim, pranim, aprovim ose aderim Shteteve Palë.
4. Në lidhje me Shtetet Palë që kanë ratifikuar, pranuar, aprovuar ose aderuar në to, ndryshimet e kësaj Konvente hyjnë në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumenteve të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni nga dy të tretat e Shteteve Palë. Pas kësaj, për çdo Shtet Palë që ratifikon, pranon, aprovon ose aderon në një ndryshim, ky ndryshim hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit nga ky Shtet Palë i instrumentit të tij të ratifikimit, pranim, aprovimit apo aderimit.
5. Një Shtet që bëhet Palë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, nëse nuk shpreh një qëllim tjetër, konsiderohet:
 - a) Palë në Konventë me ndryshimet përkatëse;
 - b) Palë në Konventën e pandryshuar në lidhje me çdo Shtet Palë që nuk u nënshtrohet ndryshimeve.

Procedura e veçantë e ndryshimeve për anekset e Konventës

1. Nëse Agjencia Botërore Antidoping ndryshon listën e ndaluar apo standardet për lejimin e përjashtimeve për përdorim terapeutik, ajo njofton Drejtorin e Përgjithshëm të UNESCO-s për këto ndryshime nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asaj/atij. Drejtori i Përgjithshëm informon menjëherë për këto ndryshime si ndryshime të propozuara për anekset përkatëse të kësaj Konvente të gjitha Shtetet Palë. Ndryshimet e anekseve aprovohen nga Konferenca e Palëve në një nga sesionet e saj ose nëpërmjet konsultimeve me shkrim.
2. Shtetet Palë kanë 45 ditë nga njoftimi i Drejtorit të Përgjithshëm, brenda të cilave ato shprehin kundërshtimin e tyre për ndryshimin e propozuar me shkrim, në rastin e konsultimit me shkrim, te Drejtori i Përgjithshëm ose në një sesion të Konferencës së Palëve. Nëse nuk shprehin kundërshtim dy të tretat e Palëve, ndryshimi i propozuar konsiderohet të aprovohet nga Konferenca e Palëve.
3. Ndryshimet e aprovuara nga Konferenca e Palëve u njoftohen Shteteve Palë nga Drejtori i Përgjithshëm. Ato hyjnë në fuqi 45 ditë pas atij njoftimi, përveç kur një Shtet Palë ka njoftuar paraprakisht Drejtorin e Përgjithshëm që ai nuk i pranon këto ndryshime.

4. Një Shtet Palë që ka njoftuar Drejtorin e Përgjithshëm që ai nuk pranon një ndryshim të aprovuar në pajtim me paragrafët e mësipërm, i nënshtrohet aneksit të pandryshuar.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35

Sistemet kushtetuese federale ose jounitare

Dispozitat e mëposhtme zbatohen për Shtetet Palë që kanë një sistem kushtetues federal ose jounitar:

a) në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente, zbatimi i të cilave është nën juridiksionin ligjor të pushtetit legjislativ federal ose qendror, detyrimet e qeverisë federale ose qendrore janë të njëjta, si edhe për ato Shtete Palë që nuk janë Shtete federale;

b) në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente, zbatimi i të cilave është nën juridiksionin e shteteve përbërëse individuale, rajoneve, provincave apo kantoneve që nuk janë të detyruara nga sistemi kushtetues i federatës të ndërmarrë masa legjislative, qeveria federale informon organet kompetente të këtyre shteteve, rajoneve, provincave ose kantoneve për këto dispozita, së bashku me rekomandimet e saj për miratim.

Neni 36

Ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi

Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimi, aprovimit ose aderimit nga Shtetet Palë, shtete të UNESCO-s në pajtim me procedurat e tyre përkatëse kushtetuese. Instrumentet e ratifikimit, pranimi, aprovimit ose aderimit depozitohen te Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s.

Neni 37

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmuor pas datës së depozitimit të instrumentit të trembëdhjetë të ratifikimit, pranimi, aprovimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që e shpreh më vonë pëlqimin e tij për t'iu nënshtuar asaj, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmuor pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi, aprovimit ose aderimit.

Neni 38

Shtrirja territoriale e Konventës

1. Çdo shtet, në momentin e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi, aprovimit apo aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ai është përgjegjës dhe te të cilët kjo Konventë zbatohet.

2. Çdo Shtet Palë, në një datë të mëvonshme dhe me një deklaratë drejtuar UNESCO-s, mund ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor që përcaktohet në deklaratë. Në lidhje me këtë territor, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmuor pas datës së marrjes së një deklarimi të tillë nga depozituesi.

3. Çdo deklaratë e bërë në pajtim me dy paragrafët e mësipërm, në lidhje me çdo territor të përcaktuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar UNESCO-s. Kjo tërheqje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmuor pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga depozituesi.

Neni 39

Denoncimi

Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Konventë. Denoncimi njoftohet nëpërmjet një instrumenti me shkrim, depozituar te Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s. Denoncimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati gjashtëmuor pas marrjes së instrumentit të denoncimit. Ky nuk ka efekt mbi detyrimet financiare të Shtetit Palë përkatës deri në datën kur tërheqja hyn në fuqi.

Neni 40

Depozituese

Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s është depozituesi i Konventës dhe i ndryshimeve të saj. Si depozitues, Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s informon Shtetet Palë në Konventë, si dhe Shtetet e tjera Anëtare të Organizatës për:

- a) depozitim të çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit;
- b) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në pajtim me nenin 37;
- c) çdo raport të përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 31;
- d) çdo ndryshim të Konventës ose të anekseve të miratuara në pajtim me nenet 33 dhe 34 dhe datën në të cilën ndryshimi hyn në fuqi;
- e) çdo deklaram ose njoftim të bërë në bazë të dispozitave të nenit 38;
- f) çdo njoftim të bërë në bazë të dispozitave të nenit 39 dhe datën kur denoncimi hyn në fuqi;
- g) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Konventë.

Neni 41

Regjistrimi

Në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë regjistrohet te Sekretariati i Kombeve të Bashkuara me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s.

Neni 42

Tekstet autentike

1. Kjo Konventë, duke përfshirë edhe anekset e saj, është përpiluar në gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku të gjashta tekstet janë njësoj autentike.
2. Shtesat në këtë Konventë janë në gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle.

Neni 43

Rezervat

Nuk lejohet asnjë rezervë që nuk pajtohet me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.

Aneks I – Lista e ndaluar – Standardi ndërkombëtar

Aneksi II – Standardet për lejimin e përjashtimeve për përdorim terapeutik

Shtesa 1 – Kodi Botëror Antidoping

Shtesa 2 – Standardi ndërkombëtar për laboratorët

Shtesa 3 – Standardi ndërkombëtar për testimin

Depozitues:

Hyrja në fuqi

Në pajtim me nenin 37, kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmuor pas depozitimit të instrumentit të trembëdhjetë të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit. Për çdo shtet që e shpreh më vonë pëlqimin e tij për t'iu nënshtruar asaj, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmuor pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit.

Tekstet autentike

Në gjuhën arabe, angleze, kineze, frënge, spanjolle dhe ruse.

Shtetet Palë

Listë në rend alfabetik

Listë në rend kronologjik

Deklarata dhe rezerva

Danimarkë

Instrumenti i ratifikimit përmbante deklarin e mëposhtëm:

“Jusqua’á décision ultérieure, la Convention ne s’appliquera pas aux îles Féroé et au Groenland. “(origjinali: frëngjisht)”

Zelanda e Re

Instrumenti i pranimit përmbante deklarin e mëposhtëm:

“Dhe deklaroi se në pajtim me statusin kushtetues të Tokelaut dhe duke marrë parasysh përkushtimin e Qeverisë së Zelandës së Re për zhvillimin e vetëqeverisjes së Tokelaut me anë të një akti të vetëvendosjes nën Kartën e Kombeve të Bashkuara, ky pranim nuk shtrihet në Tokelau përveç kur, dhe derisa nuk, paraqitet një Deklaratë nga Qeveria e Zelandës së Re te depozituesi bazuar mbi një konsultim të përshtatshëm me atë territor,” [origjinali: në anglisht].

SHTOJCA I

AGJENCIA BOTËRORE ANTIDOPINGU

KODI BOTËROR ANTIDOPING

LISTA E NDALUAR PËR VITIN 2005

STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Teksti zyrtar i listës së ndaluar do të mbahet nga ana e Agjencisë Botërore të Antidopingut (WADA) dhe do të publikohet në anglisht dhe në frëngjisht. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet versionit anglisht me atë frëngjisht, ka përparësi versioni në gjuhën angleze.

Lista hyn në fuqi në janar 2005.

LISTA E NDALUAR PËR VITIN 2005

KODI BOTËROR I ANTIDOPINGUT

E vlefshme më 1 janar 2005

Përdorimi i çdo ilaçi duhet të kufizohet për indikacione të justifikuara nga ana mjekësore

SUBSTANCA DHE METODA TË NDALUARA NË ÇDO KOHË
(BRENDA DHE JASHTË GARAVE)

SUBSTANCA TË NDALUARA

S1. AGJENTËT ANABOLIKË

Agjentët anabolikë janë të ndaluar.

1. Steroidet Androgjene Anabolike (AAS)

a) AAS të tipit ekzogjen (me origjinë të jashtme), që përfshijnë:

18 α -homo-17 β -hydroxyestr-4-en-3-one; bolasterone, boldenone; boldione; calusterone; clostebol; danazol; dehydrochloromethyl-testosterone; delta1-androstene-3,17-dione; delta1-androstenediol; delta1-dihydro-testosterone; drostanolone; ethyltestrenol; fluoxymesterone; formebolone; furazabol; gestrinone; 4-hydroxytestosterone; 4-hydroxy-19-nortestosterone; mestanolone; mesterolone; metenolone; methandienone; methandiol; methyldienolone; methyltrienolone; methyltestosterone; mibolone; nandrolone; 19-norandrostenediol; 19-norandrostenedione; norbolethone; norclostebol; norethandrolone; oxabolone; oxandrolone; oxymesterone; oxymethelone; quinbolone; stanazolol; stebolone; tetrahydrogestrinone; trenbolone dhe substanca të tjera me një strukturë kimike të ngjashme apo me efekte biologjike të ngjashme.

b) AAS të tipit endogjen (me origjinë të brendshme), që përfshijnë:

Androstenediol (androst-5-ene-3 β , 17 β -diol); androstenedione (androst-4-ene-3,17-dione); dehydroepiandrosterone (DHEA); dihydro-testosterone; testosterone si dhe metabolitet dhe izomerët e mëposhtëm: 5 α -androstane-3 α ,17-diol; 5 α -androstane-3 α , 17 β -diol; 5 α -androstane-3 β ,17 α -diol; 5 α -androstane-3 β ,17 β -diol; androst-4-ene-3 α ,17 α -diol; androst-4-ene-3 α ,17 β -diol; androst-4-ene-3 β ,17 α -diol; androst-5-ene-3 α ,17 α -diol; androst-5-ene-3 α ,17 β -diol; androst-5-ene-3 β ,17 α -diol; 4-androstenediol (androst-4-ene-3 β ,17 β -diol); 5 androstenedione (androst-5-ene-3,17-dione); epi-dihydrotestosterone; 3 α -hydroxy-5 α -androstane-17-one; 3 β -hydroxy-5 α -androstane-17-one; 3 β -hydroxy-5 α -androstane-17-one; 19-norandrosterone; 19-noretiocholanolone.

Kur një substancë e ndaluar (sipas listës më sipër) është e mundur të prodhohet nga ana e trupit në mënyrë natyrale, një mostër konsiderohet se përmban këtë substancë të ndaluar, kur përqendrimi i substancës së ndaluar ose i metaboliteve dhe treguesve të saj dhe/ose i çdo përpjesëtimi tjetër që ka lidhje në mostrën e atletit, devijon nga hapësira e vlerave që gjenden normalisht në trupin e njeriut aq sa është e pamundur të jetë në përputhje me prodhimin normal të brendshëm të trupit. Një mostër konsiderohet se nuk përmban një substancë të ndaluar në të gjitha rastet kur atleti jep prova të faktura që përqendrimi i substancës së ndaluar, i metaboliteve apo treguesve të saj dhe/ose kur përpjesëtimet në lidhje me mostrën e atletit i atribuohen një kushti të caktuar psikologjik apo patologjik. Në të gjitha rastet dhe për çdo lloj përqendrimi, laboratorit duhet të raportojë një përfundim analitik të disfavorshëm, nëse, bazuar mbi çdo metodë analitike të besueshme, ai mund të vërtetojë që substanca e ndaluar është me origjinë ekzogjene (të jashtme).

Nëse rezultati i laboratorit nuk është përfundimtar dhe nëse nuk është gjetur një përqendrim ashtu siç shprehet në paragrafin e mësipërm, organizmi përkatës antidoping duhet të kryejë një hetim të mëtejshëm, nëse ka tregues seriozë, të tilla si një krahasim me profilin e stereoidit të referencës, për një përdorim të mundshëm të substancës së ndaluar.

Nëse laboratorit ka raportuar një prani në urinë të përpjesëtimit të T ndaj E më të madh se katër (4) me një (1), investigimi i mëtejshëm është i detyrueshëm për të përcaktuar, nëse ky raport është si shkak i ndonjë kushti psikologjik apo patologjik, përveçse në rastet kur laboratorit raporton një përfundim analitik të disfavorshëm të bazuar në çfarëdo metode analitike të besueshme, që tregon se substanca e ndaluar është e një origjine të jashtme.

Në rast të ndonjë hetimi, ai do të përfshijë një rishikim të çdo testi të mëparshëm dhe/apo në vijim. Nëse testet e mëparshme nuk janë më të disponueshme, atleti duhet të testohet pa u njoftuar më parë, të paktën tri herë brenda një periudhe prej tre muajsh.

Nëse një atlet nuk bashkëpunon në hetimet që bëhen, mostra e atletit do të gjykohej se ka një substancë të ndaluar.

2. Agjentë të tjerë anabolikë, që përfshijnë, por që nuk kufizohen vetëm me substancat:

Clenbuterol, zeranol, zilpaterol.

Për qëllime të këtij seksioni:

*Termi “ekzogjen” i referohet një substance, e cila nuk është e mundur të prodhohet nga ana e trupit të njeriut në mënyrë natyrale.

** Termi “endogjen” i referohet një substance e cila është e mundur të prodhohet nga ana e trupit të njeriut në mënyrë natyrale.

S2. HORMONET DHE SUBSTANCAT PËRKATËSE

Substancat në vijim, përfshirë edhe substanca të tjera me një strukturë kimike të ngjashme apo me efekte biologjike të ngjashme, si dhe faktorët e tyre çlirues, janë të ndaluara:

1. Erythropoietin (EPO);

2. Hormoni i Rritjes (Hgh), faktori i rritjes i ngjashëm me insulinën (IGF-1), Faktorët e Rritjes Mekanike (MGF);

3. Gonadotrophins (LH, hCG);

4. Insulin;

5. Corticotrophins.

Përveçse në rastet kur atleti mund të demonstrojë që përqendrimi është për shkak të një kushti psikologjik ose patologjik, një mostër konsiderohet se përmban këtë substancë të ndaluar (siç tregohen më sipër) kur përqendrimi i substancës së ndaluar ose i metaboliteve dhe treguesve të saj, dhe/ose i

çdo përpjesëtimi tjetër që ka lidhje me mostrën e atletit devijon aq shumë nga hapësira e vlerave që gjenden normalisht në trupin e njeriut sa që është e pamundur të jetë në përputhje me prodhimin normal të brendshëm të tij.

Prania e substancave të tjera me një strukturë të ngjashme kimike ose me efekte biologjike të ngjashme, treguesit diagnostikues ose faktorët me efekte çliruese të një hormoni të listës së mësipërme të substancave, ose të çdo rezultati tjetër të cilat tregojnë se substanca e zbuluar është e një origjine të jashtme, do të raportohen si një përfundim analitik i disfavorshëm.

S3. AGONISTËT BETA-2

Të gjithë agonistët Beta-2, përfshirë edhe izomerët e tyre D dhe L janë të ndaluar. Përdorimi i tyre kërkon marrjen e një përjashtimi për përdorimin terapeutik të tyre.

Si përjashtim, formoteroli, salbutamoli, salmeteroli dhe terbutalina, kur administrohen nëpërmjet frymëmarrjes për të parandaluar dhe/ose mjekuar azmën, si dhe të ushtrimeve që shkaktjnë shtrëngime bronko-azmatike, kërkojnë një përjashtim për përdorimin terapeutik të përkohshëm.

Megjithë dhënien e përjashtimit për përdorimin terapeutik, kur laboratorit ka raportuar një përqendrim të salbutamolit (e lirë plus glucuronide) më të madh se 1000 ng/ML, kjo do të konsiderohet se përbën një përfundim analitik të disfavorshëm, përveç se kur atleti provon me fakte konkrete se rezultati jo normal ka ardhur si pasojë e përdorimit terapeutik të salbutamolit të marrë për frymëmarrjen.

S4. AGJENTËT ME AKTIVITET ANTIESTROGJENIK

Janë të ndaluar përdorimi i klasave të mëposhtme të substancave anti-estrogjenike:

1.7 Agjentët aromatikë frenues, që përfshijnë, por që nuk kufizohen me anastrozolin, letrozolin, aminogluthetimide, exemestane, formestane, testolactone.

2.7 Modulatorët receptorë estrogjenë selektivë (SERM), që përfshijnë, por që nuk kufizohen me raloxifen, tamoxifen, toremifen.

3.7 Substanca të tjera antiestrogjenike, që përfshijnë, por nuk kufizohen me clomiphene, cyclofenil, fulvestrant.

S5. DIURETIKËT DHE AGJENTËT E TJERË MASKUES

Diuretikët dhe agjentët e tjerë maskues janë të ndaluar.

Agjentët maskues përfshijnë, por nuk kufizohen me:

Diuretikët*, epitestosterone, probenecid, agjentët aromatikë alpha-reductase (si p.sh. finasteride, dutasteride), zgjeruesit e plazmës (p.sh. albumin, dextran, niseshte hydroxyethyl).

Diuretikët përfshijnë:

Acetazolamide, amiloide, bumetanide, canrenone, chlortalidone, acid etacrynic, furosemide, indapamide, metolazone, spironolactone, thiazides (p.sh. bendroflumethiazide, chlorothiazide, hydrochlorothiazide) triamterene dhe substanca të tjera me një strukturë kimike të ngjashme apo efekte biologjike të ngjashme.

* Një përjashtim për përdorim terapeutik nuk është i vlefshëm nëse urina e një atleti përmban një diuretik të shoqëruar me nivele të pragut ose nënpragut të lejuar të një ose disa substancave të ndaluar.

METODAT E NDALUARA

M1. SHITIMI I TRANSFERIMIT TË OKSIGJENIT

Veprimet e mëposhtme janë të ndaluar:

a) Dopingi i gjakut, përfshi përdorimin e gjakut autologous, homologous ose heterologous, ose të produkteve të ruazave të kuqe të gjakut të çdo lloji origjine, përveç se në rastet e veçanta të trajtimit mjekësor.

b) Shtimi artificial i aspirimit, transportin ose dhënien e oksigjenit, që përfshin, por nuk kufizohet me substancat perfluorochemichals, efaproxiralet (RSR13) dhe produkte të hemoglobinës së modifikuar (të tilla si zëvendësues të gjakut bazuar mbi hemoglobinën, produkte të hemoglobinës në mikro-kapsula).

M2. MANIPULIMI KIMIK DHE FIZIK

Veprimet e mëposhtme janë të ndaluar:

Falsifikimi ose tentativat për manipulim, që kanë si qëllim ndryshimin e integritetit dhe të vlefshmërisë së mostrave që merren për kontrollin e dopingut.

Këto veprime përfshijnë, por nuk kufizohen me infuzionet intravenoze*, aplikimin e kateterizmit (marrjen e lëngjeve të brendshme me gyp thithës) dhe zëvendësimin e urinës.

* Përveç se në rastet akute të trajtimit mjekësor legjitim, infuzionet intravenoze janë të ndaluara.

M3. DOPINGU I GENEVE

Është i ndaluar përdorimi joterapeutik i qelizave, i gjeneve, i elementeve gjenetike ose modulimi i shprehjes së gjeneve që kanë aftësinë e rritjes së performancës atletike.

SUBSTANCAT DHE METODAT E NDALUARA GJATË GARAVE

Përveç kategorive S1 deri në S5 dhe M1 deri në M3 të përcaktuara më sipër, janë të ndaluara gjatë garave edhe kategoritë e mëposhtme:

SUBSTANCAT E NDALUARA

S6. STIMULANTËT

Stimulantët e mëposhtëm janë të ndaluar, përfshi të dy izomerët e tyre optikë (D dhe L), kur janë të pranishëm:

Adrafinil, amfepramone, amiphenazole, amphetamine, amphetaminil, benzphetamine, bromantan, carphedon, cathine*, clobenzorex, cocaine, dimethylamphetamine, ephedrine**, etilamphetamine, etilefrine, famprofazone, fencamfamin, fencamine, fenetylline, fenfluramine, fenproporex, furfenorex, mefenorex, mephentermine, mesocarb, methamphetamine, methylamphetamine, methylenedioxyamphetamine, methylenedioxy-methamphetamine, methyl-ephedrine**, methylphenidate, modafinil, mikethamide, norfenfluramine, parahydroxyamphetamine, pemoline, shendi- metrazine, phenmetrazine, phentermine, prolintane, selegiline, strychnine dhe substanca të tjera me një strukturë të ngjashme kimike ose efekt (e) *** të ngjashme biologjike.

* Përdorimi i Cathine-s ndalohet kur përqendrimi në urinë është më i madh se 5 mikrogram për mililitër.

** Përdorimi i çdo lloji të ephedrine-s dhe methylephedrine-s ndalohet kur përqendrimi i saj në urinë është më i madh se 10 mikrogram për mililitër.

*** Substancat e përfshira në programin e monitorimit të vitit 2005 (bupropion, kafeina, phenylephrine, phenylpropanolamine, pipradol, pseudoephedrine, synephrine) nuk konsiderohen si substanca të ndaluara.

SHËNIM: Adrenalina e shoqëruar me agjentë të anestezisë lokale ose me përdorim lokal (për shembull hundor, oftalmologjik) nuk është e ndaluar.

S7. NARKOTIKËT

Është i ndaluar përdorimi i narkotikëve të mëposhtëm:

Buprenorphine, dextromoramide, diamorphine (heroin), fentanyl dhe derivatet e tij, hydromorphone, metadone, morphine, oxycodone, oxymorphone, pentazocine, pethidine.

S8. KANABINOIDET

Është i ndaluar përdorimi i kanabinoideve (për shembull hashishi, marijuana)

S9 GLUKOKORTIKOSTEROIDET

Ndalohet përdorimi i të gjitha glukokortikosteroideve kur përdoren nga goja, nëpërmjet zorrëve, nëpërmjet venave ose muskujve. Përdorimi i tyre bëhet vetëm me anë të miratimit të përjashtimit për përdorim terapeutik.

Të gjitha rrugët e tjera të përdorimit kërkojnë një përjashtim të shkurtuar të përdorimit terapeutik. Preparatet dermatologjike nuk janë të ndaluara.

SUBSTANCAT E NDALUARA NË SPORTE TË VEÇANTA

P1. ALKOOLI

Alkooli (ethanoli) është i ndaluar në gara vetëm në sportet e mëposhtme. Zbulimi i përdorimit të tij kryhet nëpërmjet analizës së frymëmarrjes dhe/ose gjakut. Pragu i ndaluar i dopingut për çdo federatë është dhënë si më poshtë në kllapa:

- Aeronautikë (FAI)	(0,20 g/L)	
- Loja me harqe (FITA)	(0,10 g/L)	
- Automobilizëm (FIA)	(0,10 g/L)	
- Bilardo (WCBS)	(0,20 g/L)	
- Boules (lojë me top)(CMSB)	(0,10 g/L)	
- Karate (WKF)	(0,10 g/L)	
- Pesëgarësh modern (UIPM)	(0,10 g/L)	për disiplinat që përfshijnë qitjen,
- Motoçiklizëm (FIM)	(0,00 g/L)	
- Ski (FIS)	(0,10 g/L)	

P2. NEUTRALIZUESIT – BETA

Përveç se në rastet kur përcaktohet ndryshe, është i ndaluar përdorimi i neutralizuesve-Beta vetëm në sportet e mëposhtme:

- Aeronautikë (FAI),
- Loja me harqe (FITA) (i ndaluar edhe jashtë garës),
- Automobilizëm (FIA),
- Bilardo (WCBS),
- Bobsleigh (loja me rrëshqitjen e lojtarëve me slitë mbi dëborë) (FIBT),
- Boules (lojë me top) (CMSB),
- Brixh (FMB),
- Shah (FIDE),
- Curling (loja e gurëve me dorezë mbi akull) (WCF),
- Gjimnastikë (FIG),
- Motoçiklizëm (FIM),
- Pesëgarësh modern (UIPM), për disiplinat që përfshijnë qitjen,
- Bowling me 9 gurë (FIQ),
- Vozitje (ISAF) vetëm për garat e lojërave me timon drejtues,
- Qitje (ISSF) (i ndaluar gjithashtu edhe jashtë garës),
- Ski (FIS), në hedhjet me ski dhe në rrëshqitjen stil i lirë me bord mbi dëborë,
- Not (FINA) në hedhjet nga trampolina dhe notimin e sinkronizuar,
- Mundje (FILA).

Neutralizuesit-Beta përfshijnë, por nuk janë të kufizuar me sa vijon:

Acebutolol, alprenolol, atenolol, betaxolol, bisoprolol, bunolol, carteolol, carveditol, celiprolol, esmolol, labetalol, levobunolol, metipranolol, metoprolol, nadolol, oxprenolol, pindolol, propranolol, sotalol, timolol.

SUBSTANCAT E SPECIFIKUARA*

“Substancat e specifikuara”* janë listuar si më poshtë:

- ephedrine, L-methylamphetamine, methylephedrine;
- cannabinoid-et
- të gjithë agonistët Beta-2 që merren me rrugët e frymëmarrjes, me përjashtim të clenbuterol-

it;

- probenecid-i;
- të gjithë Glucocorticosteroid-et
- të gjithë neutralizuesit beta;
- alkooli.

* “Lista e ndaluar mund të identifikojë substancat e specifikuara të cilat janë veçanërisht të ndjeshme ndaj shkeljeve të paqëllimshme të rregullave antidoping për shkak të disponueshmërisë së tyre në produktet medicinale, ose të cilat ka pak të ngjarë të përdoren me sukses si abuzim për agjentë doping.” Një shkelje e dopingut që përfshin substanca të tilla mund të rezultojë në një sanksion të reduktuar me kusht që “... Atleti të saktësojë që përdorimi i një substance të tillë të specifikuar nuk ka pasur për qëllim të rrisë performancën sportive të tij...”.

SHTOJCA II

STANDARDET PËR DHËNIEN E PËRJASHTIMIT PËR PËRDORIM TERAPEUTIK

Pjesë të nxjerra nga “Standardi ndërkombëtar për përjashtimet për përdorim terapeutik” të Agjencisë Botërore të Antidopingut (WADA), në fuqi që prej 1 janarit 2005.

4.0 Kriteret për dhënie të përjashtimit të përdorimit terapeutik

Një atleti mund t’i jepet një përjashtim për përdorim terapeutik (TUE) duke lejuar përdorimin e një substance të ndaluar ose të një metode të ndaluar të përcaktuar sipas listës së ndaluar. Një aplikim i bërë për të marrë një përjashtim për përdorim terapeutik do të shqyrtohet nga një komitet i përjashtimit për përdorim terapeutik (TUEC). Ky komitet do të caktohet nga një organizatë antidoping. Një përjashtim për përdorim terapeutik do të jepet vetëm në përputhje të plotë me kriteret e mëposhtme:

(Koment: Ky standard është i vlefshëm për të gjithë atletët sipas përcaktimit dhe që janë

objekt i Kodit, d.m.th. atletët me aftësi fizike të shëndoshë, si dhe atletët me aftësi të kufizuar. Ky standard zbatohet sipas rrethanave përkatëse të çdo individit. Për shembull, një përjashtim që mund të bëhet për një atlet me aftësi të kufizuar mund të mos jetë i përshtatshëm për atletë të tjerë.)

5.0 Për të marrë një përjashtim për përdorim terapeutik, atleti duhet të dorëzojë një aplikim jo më pak se 21 ditë përpara pjesëmarrjes në një takim sportiv.

5.0 Atleti do të pësojë një dëmtim të jashtëzakonshëm në shëndetin e tij nëse substanca e ndaluar apo metoda e ndaluar do të mbahet e fshehur gjatë trajtimit të një kondicioni mjekësor akut apo kronik.

5.0 Përdorimi terapeutik i substancës së ndaluar ose i metodës së ndaluar mund të prodhojë një rritje shtesë të performancës, ndryshe nga ajo që mund të ishte pritur nga një kthim në gjendjen normale të shëndetit që do të vinte si rezultat i një trajtimi mjekësor të një kondicioni mjekësor të ligjshëm. Përdorimi i çdo substance të ndaluar apo metode të ndaluar për të rritur nivelet “e ulëta-normale” të një hormoni endogjen nuk konsiderohet një ndërhyrje e pranueshme terapeutike.

5.0 Nuk ka asnjë alternativë terapeutike të arsyeshme që të justifikojë përdorimin e substancave të ndaluara apo metodave të ndaluara të ndryshme.

5.0 Nevoja për përdorimin e substancave të ndaluara apo metodave të ndaluara të ndryshme nuk mund të jetë një pasojë, në tërësi ose pjesërisht, e përdorimit të mëparshëm joterapeutik të çdo substance nga lista e ndaluar.

Nëse kërkohet asistencë e ekspertëve të jashtëm të pavarur, do të qarkullohen të gjitha detajet e aplikimit pa identifikuar emrin e atletit që përfshihet në përkujdesjen e atletit. Aplikanti duhet të dorëzojë, gjithashtu një pëlqim me shkrim që vendimet e Komitetit të Përjashtimit për Përdorim Terapeutik t’u vihen në dispozicion edhe organizatave të tjera antidoping bazuar në dispozitat e Kodit.

5.2 Anëtarët e Komitetit të Përjashtimit për Përdorim Terapeutik dhe drejtuesit e angazhuar të Organizatës së Antidopingut do t’i kryejnë të gjitha veprimtaritë e tyre në konfidencë të plotë. Të gjithë anëtarët e Komitetit të Përjashtimit për Përdorim Terapeutik dhe i gjithë stafi i angazhuar do të nënshkruajnë marrëveshje të konfidencialitetit. Në veçanti, ata do të mbajnë konfidencial informacionin e mëposhtëm:

a) çdo lloj informacioni dhe të dhëna mjekësore që vihen në dispozicion nga atleti dhe mjekët që angazhohen në përkujdesjen e atletit;

b) të gjitha detajet e aplikimit, përfshi emrin e mjekëve të angazhuar në proces.

Nëse atleti revokon të drejtën e Komitetit të Përjashtimit për Përdorim Terapeutik (TUEC) ose të Agjencisë Botërore të Antidopingut (WADA) për të siguruar çdo lloj informacioni në emrin e tij/ të saj, atleti duhet që për këtë fakt të njoftojë mjekun e tij/ të saj me shkrim. Si pasojë e këtij vendimi, atleti nuk do të marrë miratim për një përjashtim për përdorim terapeutik ose për rinovim të një përjashtimi për përdorim terapeutik ekzistues.

6.0 Komitetet e përjashtimit për përdorim terapeutik (TUEC)

Komitetet TUEC do të përbëhen dhe do të veprojnë në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

6.1 Komitetet TUEC duhet të përfshijnë të paktën tre mjekë me eksperiencë në përkujdesjen dhe trajtimin e atletëve dhe me njohuri të thella në mjekësinë klinike, sportive dhe të stërvitjeve. Në mënyrë që të sigurohet një nivel i nevojshëm pavarësie në marrjen e vendimeve, pjesa më e madhe e anëtarëve të Komiteteve TUEC nuk duhet të ketë ndonjë përgjegjësi tjetër në organizatën antidoping. Të gjithë anëtarët e një Komiteti TUEC do të nënshkruajnë një marrëveshje të konfliktit të interesave. Në aplikimet që përfshijnë atletët me aftësi të kufizuara, të paktën një anëtar i Komitetit TUEC duhet të ketë eksperiencë të veçantë për përkujdesjen dhe trajtimin e atletëve me aftësi të kufizuara.

6.2 Komitetet TUEC mund të kërkojnë çfarëdolloj ekspertize shkencore ose mjekësore që ata e konsiderojnë të përshtatshme në shqyrtimin e rrethanave të çdo aplikimi për një përjashtim për përdorim terapeutik.

6.3 Komiteti TUEC i Agjencisë WADA duhet të përbëhet sipas kriterëve të parashikuara në nenin 6.1. Komiteti TUEC i Agjencisë WADA është krijuar për të rishqyrtuar me iniciativën e vet vendimet e përjashtimit për përdorim terapeutik që janë dhënë nga organizatat antidoping. Ashtu siç specifikohet në nenin 4.4 të Kodit, Komiteti TUEC i Agjencisë WADA, bazuar në kërkesën e atletëve të cilëve, nuk u është miratuar përjashtimi për përdorim terapeutik nga një organizatë antidoping, ka të drejtë të rishqyrtojë këto vendime me autoritetin për t’i shfuqizuar ato.

7.0 Procesi i aplikimit të përjashtimit për përdorim terapeutik

7.1 Një përjashtim për përdorim terapeutik (TUE) do të merret në konsideratë vetëm me

marrjen e formës së aplikimit të plotësuar, e cila duhet të përfshijë të gjitha dokumentet e nevojshme (shih shtojcën 1 – formati TUE). Procesi i aplikimit duhet të trajtohet në përputhje të plotë me parimet e rrepta të konfidencialitetit mjekësor.

7.2 Format i aplikimit TUE, siç parashikohet në shtojcën 1, mund të modifikohet nga organizatat antidoping me synimin për të përfshirë kërkesa të mëtejshme informative, por asnjë seksion ose çështje nuk duhet të hiqet.

7.3 Format i aplikimit TUE mund të përkthehet në gjuhë të tjera nga ana e organizatave antidoping, por gjuha angleze ose frënge duhet të mbeten në formatin e aplikimit.

7.4 Një atlet nuk mund të aplikojë një TUE për më shumë se një organizatë antidoping. Aplikimi duhet të identifikojë sportin e atletit dhe, kur është e nevojshme, disiplinën dhe pozicionin ose rolin specifik.

7.5 Aplikimi duhet të listojë ndonjë kërkesë të mëparshme ose aktuale për leje të përdorimit të një substance të ndaluar ose të një metode të ndaluar të ndryshme, organizmin të cilit i është bërë kjo kërkesë dhe vendimin e atij organizmi.

7.6 Aplikimit duhet t'i bashkëlidhet një anamnezë e plotë mjekësore dhe rezultatet e të gjitha ekzaminimeve, shqyrtimeve laboratorike dhe studimeve me imazhe që kanë lidhje me aplikimin.

7.7 Çdo shqyrtim, ekzaminim dhe studim i mëtejshëm me imazhe, që ka lidhje me rastin konkret e që kërkohet nga Komiteti TUEC i organizatës antidoping, do të merret me shpenzimet e vetë aplikantit ose të organit administrues sportiv kombëtar të tij/të saj.

7.8 Aplikimit duhet t'i bashkëlidhet një deklaratë nga një mjek i kualifikuar i fushës, që vërteton për domosdoshmërinë e substancës së ndaluar ose të metodës së ndaluar të ndryshme, në trajtimin e atletit, duke përshkruar përse një mjekim alternativ i lejuar nuk mund të përdoret ose nuk mund të ishte përdorur në trajtimin e këtij kondicioni.

7.9 Doza, shpeshësia, rrugët e marrjes dhe kohëzgjatja e përdorimit të substancës së ndaluar ose të metodës së ndaluar të ndryshme, për të cilën bëhet fjalë duhet të specifikohen.

7.10 Vendimet e Komitetit TUEC duhet të përfundojnë brenda 30 ditësh nga data e marrjes së të gjithë dokumentacionit në fjalë dhe do t'i përcillen me shkrim atletit nga organizata e interesuar antidoping. Kur një atleti i jepet e drejta e përjashtimit për përdorim terapeutik në organin e testimit të regjistrimeve të organizatës antidoping, atletit dhe agjencisë WADA do t'u vihet menjëherë në dispozicion një fletëmiratim, i cili përfshin informacion në lidhje me kohëzgjatjen e përjashtimit dhe kushte të tjera që lidhen me përjashtimin për përdorim terapeutik.

7.11 (a) Me marrjen për shqyrtim të një kërkesë nga një atlet, ashtu siç specifikohet në nenin 4.4 të Kodit, Komiteti TUEC i agjencisë WADA ka autoritetin që të shfuqizojë një vendim mbi një përjashtim për përdorim terapeutik të dhënë nga një organizatë antidoping. Atleti duhet të vërë në dispozicion të Komitetit TUEC të agjencisë WADA të gjithë informacionin e nevojshëm për marrjen e përjashtimit për përdorim terapeutik, ashtu siç ishte paraqitur fillimisht organizatës antidoping të shoqëruar me një taksë aplikimi. Deri në përfundimin e procesit të rishqyrtimit, vendimi origjinal mbetet në fuqi. Procesi nuk duhet të zgjasë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së informacionit nga agjencia WADA.

(b) Agjencia WADA mund të kryejë një rishqyrtim në çdo kohë. Komiteti TUEC i agjencisë WADA duhet të përfundojë rishqyrtimin e tij brenda 30 ditëve.

7.12 Nëse vendimi në lidhje me dhënien e një përjashtimi për përdorim terapeutik është shfuqizuar nga rishqyrtimi i bërë atij, anulimi i vendimit nuk ka fuqi prapavepruese dhe nuk i skualifikon rezultatet e atletit gjatë periudhës që ishte dhënë përjashtimi për përdorim terapeutik, dhe do të hyjë në fuqi jo më vonë se 14 ditë pas njoftimit të atletit për vendimin.

8.0 Procesi i aplikimit për përjashtim për përdorim terapeutik të shkurtuar (ATUE).

8.1 Është e njohur se disa substanca të përfshira në listën e substancave të ndaluara përdoren për të trajtuar kondicione mjekësore që hasen shpesh në komunitetin e atletëve. Në raste të tilla, nuk është i nevojshëm një aplikim i plotë siç përshkruhet në seksionin 4 dhe seksionin 7. Për këtë qëllim, është krijuar një proces i shkurtuar i dhënies së përjashtimit për përdorim terapeutik.

8.2 Substancat e ndaluara dhe metodat e ndaluara që mund të jenë të lejuara nga ky proces i shkurtuar janë tërësisht të kufizuara për sa më poshtë:

Agonistët Beta-2 (formoterol, salbutamol, salmeterol dhe terbutaline) nëpërmjet rrugëve të frymëmarrjes, dhe glucocorticosteroidet nëpërmjet rrugëve joorganike.

8.3 Për përdorimin e një prej substancave të mësipërme, atleti duhet të vërë në dispozicion të organizatës antidoping një njoftim mjekësor që justifikon nevojën terapeutike të përdorimit të tij. Një njoftim mjekësor i tillë, siç përcaktohet në shtojcën 2, duhet të përshkruajë diagnozën, emrin e ilaçit, dozën, rrugët e marrjes së tij dhe kohëzgjatjen e trajtimit mjekësor. Kur është e aplikueshme, çdo test i kryer për të përcaktuar diagnozën duhet të bashkëlidhet (pa ndonjë rezultat aktual ose detaje).

8.4 Procesi i shkurtuar përfshin:

a) miratimin për përdorimin e substancave të ndaluara, që janë objekt i procesit të shkurtuar, bëhet i efektshëm me marrjen e një dokumentacioni të plotë nga ana e organizatës së antidopingut. Dokumentacionet jo të plota duhet t'i rikthehen mbrapsht aplikantit;

b) me marrjen e një dokumentacioni të plotë, organizata antidoping duhet të njoftojë atletin menjëherë. Kur është e nevojshme, IF-ja, NF-ja, dhe NADO-ja e atletit duhet gjithashtu të vihen në dijeni. Organizata antidoping duhet të vërë në dijeni agjencinë WADA vetëm me marrjen e një dokumentacioni nga ana e një atleti të nivelit ndërkombëtar;

c) një dokumentacion për një ATUE nuk do të konsiderohet për miratim me veprim prapaveprues, përveçse në rastet :

- Kur është e nevojshme një trajtim emergjent ose trajtim i një kondicioni mjekësor akut; ose
- Kur për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, ka mundësi dhe kohë të pamjaftueshme për një aplikant për të dorëzuar një aplikim, apo për një Komitet TUEC për të marrë një aplikim përpara kontrollit të dopingut.

8.5 a) Një rishqyrtim nga ana e Komitetit TUEC ose nga Komiteti TUEC i agjencisë WADA mund të iniciohet në çdo kohë gjatë periudhës së kohëzgjatjes së një ATUE.

b) Nëse një atlet kërkon një rishqyrtim të një mohimi pasues të një ATUE, atëherë Komiteti TUEC i agjencisë WADA do të ketë autoritetin të kërkojë nga atleti informacion shtesë mjekësor, siç gjykohej e nevojshme, shpenzimet e të cilave do të mbulohen nga ana e atletit.

8.6 Një ATUE mund të pezullohet në çdo kohë nga Komiteti TUEC ose nga Komiteti TUEC i agjencisë WADA. Atleti, IF-ja e tij/ e saj dhe të gjitha organizatat e tjera të antidopingut duhet të vihen menjëherë në dijeni.

8.7 Pezullimi hyn në fuqi menjëherë pas njoftimit të atletit për vendimin. Megjithatë, atleti ka të drejtë të aplikojë për një përjashtim për përdorim terapeutik, sipas seksionit 7.

9.0 Zyra qendrore (Clearing House).

9.1 Organizatave antidoping u kërkohet të vënë në dispozicion të agjencisë WADA të gjitha përjashtimet për përdorim terapeutik, dhe gjithë dokumentacionin e tyre mbështetës, që përcaktohet sipas seksionit 7.

9.2 Për sa i përket ATUE-ve, organizatat antidoping duhet të vënë në dispozicion të agjencisë WADA aplikimet mjekësore të dorëzuara nga atletët e nivelit ndërkombëtar që përcaktohen sipas seksioni 8.4.

9.3 Zyra qendrore do të garantojë konfidencialitet maksimal të gjithë informacionit mjekësor.

LIGJ

Nr.9624, datë 16.10.2006

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN SHUMËPALËSH TË KONVENTËS “PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE (CMR)”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin shumëpalësh të Konventës “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave (CMR)”, bërë në Gjenevë më 5 korrik 1978.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5098, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

PROTOKOLL¹

SHUMËPALËSH PËR KONVENTËN MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE (CMR)²
(BËRË NË GJENEVË, MË 5 KORRIK 1978)

Nr. 19487

Tekstet autentike: anglisht dhe frëngjisht

Regjistruar ex officio më 28 dhjetor 1980

Palët në këtë Protokoll,

- *duke qenë* Palë në Konventën mbi Kontratën e Transportit Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave (CMR),
bërë në Gjenevë, më 19 maj 1956,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e këtij Protokollit, “Konventë” është Konventa mbi Kontratën për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave (CMR).

Neni 2

Neni 23 i Konventës ndryshohet si më poshtë:

1) Paragrafi 3 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“3. Megjithatë kompensimi nuk i kalon 8.33 njësi llogaritjeje për kilogram të peshës bruto.”

2) Në fund të këtij neni shtohen paragrafët 7, 8 dhe 9:

“7. Njësia e llogaritjes, e parashikuar në këtë Konventë, është e drejta e veçantë e tërheqjes sipas përkufizimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Shuma e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni konvertohet në valutën vendase të shtetit, gjykata e të cilit shqyrton çështjen mbi bazën e vlerës së asaj valute në datën e vendimit ose në datën për të cilën kanë rënë dakord palët. Vlera e valutës vendase, në kuptimin e së drejtës së veçantë të tërheqjes, e një shteti që është anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar, llogaritet në pajtim me metodën e vlerësimit të zbatuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar që është në fuqi në datën në fjalë për operacionet dhe transaksionet e veta. Vlera e valutës vendase, në kuptimin e së drejtës së veçantë të tërheqjes, e një shteti që nuk është anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar, llogaritet në mënyrën e caktuar nga ai shtet.

8. Megjithatë, një shtet që nuk është anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe ligji i të cilit nuk lejon zbatimin e dispozitave të paragrafit 7 të këtij neni, në momentin e ratifikimit ose aderimit në Protokollin e CMR-së, apo në çdo kohë pas këtij momenti, mund të deklarojë që kufiri i detyrimit të parashikuar në paragrafin 3 të

¹ Hyri në fuqi më 28 dhjetor 1980, d.m.th. ditën e nëntëdhjetë pasi pesë shtete të përmendura në nenin 3, paragrafët 1 dhe 2 të këtij Protokollit depozituan instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit, në pajtim me nenin 4 (1):

Shteti	Data e depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit
Danimarka	20 maj 1980
Finlanda	15 maj 1980
Gjermania, Republike Federale e .. (me një deklaratë për t’u zbatuar në Berlinin Perëndimor)	29 shtator 1980
Luksemburgu	1 Gusht 1980
Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlanda e Veriut	5 tetor 1979
(Në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, Irlandën e Veriut dhe Gjibraltarin.)	

² Kombet e Bashkuara, Seria e Traktateve, vol 399, f. 189.

këtij neni për t'u zbatuar në territorin e tij është 25 njësi monetare. Njësia monetare e përmendur në këtë paragraf përputhet me 10/31 gram ar të pastërtisë nëntëqind. Konvertimi i shumës së parashikuar në këtë paragraf në valutën vendase bëhet në pajtim me ligjin e shtetit përkatës.

9. Llogaritja e përmendur në fjalinë e fundit të paragrafit 7 të këtij neni dhe konvertimi i përmendur në paragrafin 8 të këtij neni bëhet në mënyrë të tillë që të shprehë në valutën vendase të shtetit, për aq sa është e mundur, të njëjtën vlerë reale të shumës në paragrafin 3 të këtij neni siç është parashikuar atje në njësi llogaritjeje. Shtetet i komunikojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mënyrën e llogaritjes në pajtim me paragrafin 7 të këtij neni ose rezultatin e konvertimit në paragrafin 8 të këtij neni, sipas rastit, në momentin e depozitimit të një instrumenti të përmendur në nenin 3 të Protokollit të CMR-së dhe kurdoherë që ka ndryshim në ndonjërin prej tyre."

Neni 3

1. Ky Protokoll është i hapur për t'u nënshkruar nga shtetet që janë nënshkruese ose kanë aderuar në Konventë dhe janë anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën ose janë pranuar në këtë Komision në cilësinë konsultative në bazë të paragrafit 8 të termave të referencës së këtij Komisioni.

2. Ky Protokoll mbetet i hapur për aderim nga çdo shtet i referuar në paragrafin 1 të këtij neni që është Palë në Konventë.

3. Ato shtete që mund të marrin pjesë në aktivitete të caktuara të Komisionit Ekonomik për Europën, në pajtim me paragrafin 11 të termave të referencës së atij Komisioni që kanë aderuar në Konventë, mund të bëhen palë kontraktuese në këtë Protokoll duke aderuar në të pas hyrjes së tij në fuqi.

4. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim në Gjenevë nga 1 shtatori 1978 deri më 31 gusht 1979, duke përfshirë këtë ditë. Pas kësaj, ai është i hapur për aderim.

5. Ky Protokoll i nënshtrohet ratifikimit pasi shteti përkatës të ketë ratifikuar ose aderuar në Konventë.

6. Ratifikimi ose aderimi realizohet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

7. Çdo instrument ratifikimi ose aderimi, i depozituar pas hyrjes në fuqi të një amendimi të këtij Protokollit në lidhje me të gjitha palët kontraktuese ose pas marrjes së të gjitha masave të kërkuara për hyrjen në fuqi të amendimit në lidhje me të gjitha palët kontraktuese konsiderohet të zbatohet për Protokollin sipas ndryshimeve në amendim.

Neni 4

1. Ky Protokoll hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pasi pesë shtete, të referuara në nenin 3, paragrafët 1 dhe 2, të këtij Protokollit të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon ose aderon pasi pesë shtete të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit, ky Protokoll hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pasi shteti përkatës të ketë depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 5

1. Çdo palë kontraktuese mund ta denoncojë këtë Protokoll duke njoftuar për këtë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës së marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm i njoftimit për denoncimin.

3. Çdo shtet kontraktues që pushon së qeni palë në Konventë, pushon së qeni palë në këtë Protokoll në të njëjtën datë.

Neni 6

Nëse pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit, numri i palëve kontraktuese pakësohet si rezultat i denoncimeve në më pak se pesë, ky Protokoll pushon së qeni në fuqi, nga data në të cilën hyn në fuqi denoncimi i fundit. Ai pushon së qeni në fuqi edhe nga data në të cilën Konventa pushon së qeni në fuqi.

Neni 7

1. Çdo shtet, në momentin e depozitimit të instrumentit të vet të ratifikimit ose aderimit apo në çdo moment të mëvonshëm, mund të deklarojë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara që ky Protokoll shtrohet në të gjithë ose një pjesë territori të caktuar për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ai është i përgjegjshëm dhe në lidhje me të cilin ka bërë në deklaratë, në pajtim me nenin 46 të kësaj Konvente. Ky Protokoll shtrihet në territorin ose pjesët e territorit të caktuara në njoftim nga dita e nëntëdhjetë pas marrjes së tij nga Sekretari i Përgjithshëm ose, nëse në atë ditë Protokollit nuk ka hyrë

akoma në fuqi, nga momenti i hyrjes së tij në fuqi.

2. Çdo shtet që ka bërë një deklaratë në pajtim me paragrafin e mësipërm që e shtrin këtë Protokoll në një pjesë të caktuar territori për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ai është i përgjegjshëm, mund ta denoncojë këtë Protokoll specifikisht për këtë pjesë territori në pajtim me dispozitat e nenit 5 të mësipërm.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Protokoll, të cilin palët nuk janë në gjendje ta zgjidhin me bisedime ose mjete të tjera, me kërkesë të njëres nga palët kontraktuese të interesuara, mund t'i referohet për zgjidhje Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Neni 9

1. Çdo palë kontraktuese, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë Protokoll, mund të deklarojë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se ai nuk e konsideron veten të detyruar nga neni 8 i këtij Protokoll. Palët e tjera kontraktuese nuk i nënshtrohen nenit 8 të këtij Protokoll në lidhje me çdo palë kontraktuese që ka bërë një rezervë të tillë.

2. Deklarimi i referuar në paragrafin 1 të këtij neni mund të tërhiqet në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Nuk lejohet asnjë rezervë tjetër për këtë Protokoll.

Neni 10

1. Pasi ky Protokoll të ketë qenë në fuqi për tre vjet, çdo palë kontraktuese, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, mund të kërkojë të thirret një konferencë për qëllimin e rishikimit të këtij Protokoll. Sekretari i Përgjithshëm njofton të gjitha palët kontraktuese në lidhje me kërkesën dhe një konferencë rishikuese thirret nga Sekretari i Përgjithshëm nëse, brenda një afati prej katër muajsh pas datës së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, jo më pak se një e katërta e Palëve Kontraktuese e njoftojnë atë për aprovimin e tyre për kërkesën.

2. Nëse thirret një konferencë në pajtim me paragrafët e mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm njofton të gjitha palët kontraktuese dhe i fton ato të paraqesin brenda një afati prej tre muajsh ato propozime që ato duan të shqyrtohen nga Konferenca. Sekretari i Përgjithshëm e qarkullon axhendën provizore të konferencës së bashku me tekstet me këto propozime të të gjitha shtetet kontraktuese të paktën tre muaj para datës në të cilën është caktuar të mbahet konferenca.

3. Sekretari i Përgjithshëm fton në çdo konferencë që thirret në pajtim me këtë nen të gjitha vendet e përmendura në nenin 3, paragrafi 1 dhe 2, dhe shtetet që janë bërë palë kontraktuese në bazë të nenit 3 paragrafi 3 i këtij Protokoll.

Neni 11

Përveç njoftimeve të parashikuara në nenin 10, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara njofton vendet e përmendura në nenin 3 paragrafi 1 dhe 2, dhe shtetet që janë bërë palë kontraktuese në bazë të nenit 3 paragrafi 3, në lidhje me:

- a) ratifikimet dhe aderimet në bazë të nenit 3;
- b) datat e hyrjes në fuqi të këtij Protokoll në pajtim me nenin 4;
- c) komunikimet e marra në bazë të nenit 2 paragrafi 2;
- d) denoncimet në bazë të nenit 5;
- e) pushimin e efektit të këtij Protokoll në bazë të nenit 6;
- f) njoftimet e marra në pajtim me nenin 7;
- g) deklarinimet dhe njoftimet e marra në pajtim me nenin 9, paragrafët 1 dhe 2.

Neni 12

Pas 31 gushtit 1979, origjinali i këtij Protokoll depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, që i transmeton kopje të vërtetuara të gjitha shteteve të përmendura në nenin 3, paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij Protokoll.

Bërë në Gjenevë, më pesë korrik, një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë, në një kopje të vetme në

gjuhën angleze dhe frënge, ku secili tekst është njëloj autentik.

Si dëshmi e kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

LIGJ
Nr.9625, datë 16.10.2006

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8618, DATË 14.6.2000 “PËR
TELEKOMUNIKACIONET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Ruajtja dhe administrimi i të dhënave për qëllime të ndjekjes penale

Pavarësisht nga neni 22 i ligjit, për qëllime të gjurmimit e parandalimit të veprave penale dhe të procedimit penal, operatori publik i telekomunikacioneve detyrohet të ruajë dhe të administrojë, për një afat dyvjeçar, skedarët e të dhënave për përdoruesit e shërbimeve të tij.

Skedarët e të dhënave për përdoruesit e shërbimeve publike të telekomunikacionit duhet të mbajnë të dhëna që mundësojnë:

a) identifikimin e përdoruesve të shërbimeve publike të telekomunikacionit, duke siguruar marrjen dhe regjistrimin e identitetit të plotë të tyre;

b) identifikimin e tipit të pajisjes fundore, të përdorur gjatë komunikimeve;

c) përcaktimin e datës, orës dhe kohëzgjatjes së komunikimeve.

Këta skedarë duhet t’u vihen në dispozicion, edhe në formë elektronike, autoriteteve që përcakton Kodi i Procedurës Penale, në bazë të kërkesës së tyre.”.

Neni 2

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29

Për përdorimin e shërbimeve telefonike publike, operatori i shërbimeve telefonike publike lidh kontratë me përdoruesit. Çdo kontratë, në zbatim të nenit 24 të ligjit, duhet të përmbajë identitetin e plotë të përdoruesit të shërbimit publik telefonik.

Kontrata tip, që lidhet ndërmjet operatorit dhe përdoruesit, duhet të mbështetet në parimin e barazisë kontraktore të palëve. Ajo hartohet nga operatori dhe miratohet nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Përfundimisht bëjnë përdoruesit, që janë abonentë me kartë të parapaguar të operatorëve të shërbimeve publike të telefonisë së lëvizshme. Pavarësisht nga kjo, në zbatim të nenit 24 të ligjit, operatorët e shërbimeve publike të telefonisë së lëvizshme detyrohen të regjistrojnë identitetin e plotë të abonentëve me kartë të parapaguar, përpara aktivizimit të shërbimit.”.

Neni 3

Shkronja “c” e pikës 2 të nenit 96 ndryshohet si më poshtë:

“c) shkelen nenet 24, 25, 29 ose 98/1.”.

Neni 4

Pas nenit 98 shtohet neni 98/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 98/1

Operatorët publikë të telekomunikacioneve detyrohen të marrin masat dhe të bëjnë regjistrimin e përdoruesve me kontratë pajtimi ose me shërbim të parapaguar, sipas përcaktimeve të nenit 29 të ligjit, deri në datën 1 korrik 2007.

Operatorët publikë të telekomunikacioneve detyrohen ta ndërpresin këtë shërbim për përdoruesit, të cilët, në përfundim të afatit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, nuk paraqiten pranë tyre dhe nuk përmbushin detyrimet e parashikuara në nenin 29 të këtij ligji.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton formularin me të dhënat, të cilat janë të detyrueshme të jepen nga abonentët, për të mundësuar regjistrimin e tyre sipas këtij neni.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5099, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9626, datë 16.10.2006

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.9072, DATË 22.5.2003
“PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas pikës 35 të nenit 2 shtohet pika 35/1 me këtë përmbajtje:

“35/1. Shkëmbimi dhe shitja e energjisë elektrike, në kuptim të këtij ligji, është marrëdhënia juridike midis palëve, sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil.”.

Neni 2

Pas shkronjës “k” të nenit 8 shtohet shkronja “l” me këtë përmbajtje:

“1) miraton rregullat dhe procedurat, sipas të cilave bëhen shkëmbimi dhe shitja e energjisë elektrike të furnizuesit vendas e të huaj, kur e kërkon situata energjetike.”.

Neni 3

Pas nenit 65 shtohet neni 65/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 65/1

Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton rregullat dhe procedurat, sipas të cilave bëhen shkëmbimi dhe shitja e energjisë elektrike për shoqëritë publike që kryejnë këto veprime.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5100, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 14 .11.2006
Doli nga shtypi më 17.11.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë